

100 vjetori i lindjes së Arshi Pipës, një personalitet i kulturës shqiptare, u kremtua përmes një konference në hapësirat e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, ku referuan njohës së mirë të veprës së tij, si Dr. Primo Shllaku, Dr. Leka Ndoja, profesor Hektor Çiftja, botuesja e “Princit” Irena Buzi, si dhe studiuesja Luljeta Prençi. I pranishëm ishte dhe nipi i Pipës, z. Plator Kalakulla.

Arshi Pipa DOMETHËNIA E ARTIT




Bisedë me botuesen
e veprës së Arshi Pipës

(fq. 4)

IRENA BUZI:
Bashkëpunimi me
motrat Pipa, një shkollë
më vete për mua

Me përqaftimin e njerëzimit, veprimi moral e ka kryer misionin e vet. Përtej kësaj pike ai nuk mund të shkojë. Në këtë drejtim, kufijtë janë mbyllur. Por moraliteti nuk e shteron dinjitetin njerëzor. Dhe, kur njeriu pushon së vepruari, zbulon natyrën. Ç’është natyra? Është mbretëria e ndjeshmërisë, është tërësia e gjithçkaje që është trup: është kafsha, bima, fushat e lumenjtë, pyjet e malet, e gjithë toka; por edhe qielli e yjet.




(fq. 2)

NJË VËSHTRIM MBI DY VARIANTET E NJË VJERSHE TË FAN NOLIT

Nga Sevdai Kastrati

(fq. 10)

Vjershën e tij të njohur “Krishti me kamçikun” Fan Noli e shkroi gjatë qëndrimit në Vjenë më 1927 dhe e botoi për herë të parë pas 18 vjetësh në gazetën “Dielli” më 26 dhjetor 1945 me pseudonimin tashmë të njohur Robo Rogozhina. Vjersha “Krishti me kamçikun” njohu dy botime dhe kemi një dorëshkrim autograf..



Proust, Nabokov, Gogol
dhe dorëshkrimet e djegura

Pse disa shkrimtarë i djegin veprat e tyre?

nga Alex George

(fq. 18)



BIBLIOTEKË

Rudolf Marku

(fq. 12)

Krilla e kujtimit tënd

Xheni Shehaj

(fq. 13)

Frida

Arb Elo

(fq. 14)

Kënga e këngëve

Andi Meçaj

(fq. 15)

Shi i butë kurmesh

Sophia Maria Popovska

(fq. 16)

Fytyra në turmë

Mbi librin e Anton Berishajt, “Fenomenologjia e vdekjes”

VLERA ESTETIKE E FENOMENOLOGJISË SË POEZISË

nga Ndue Ukaj

(fq. 10)

LETËRKËMBIM MUSTAFA KRUJA – MARTIN CAMAJ

Është interesant fakti që letra e parë e Mustafa Krujes fillon me një përgëzim e vlerësim të poetit të ri, për të cilin firmëtar i Shpalljes së Pamvarësisë shkruan: “talentin t’uej qi premtion shumë e mirë për letërsinë shqiptare”

(fq. 8)

MBI KRIJIMTARINË E XHEVDET BAJRAJT

POEZI E DINJITETIT MBI GËRMADHA

Nga Shqiptar Oseku

Ekziston një teori e diskutueshme, determinizmi nominativ, që thotë se personaliteti i njerëzve sajohet nga emërtimet: nga fjalët me të cilat pagëzohet njeriu a vendi ku është rritur ai. Në rastin e poetit Xhevdet Bajraj, kjo teori mund të jetë dyfish e saktë.

(fq. 6)

Arshi Pipa

DOMETHËNIA E ARTIT

Me përqaftimin e njerëzimit, veprimi moral e ka kryer misionin e vet. Përtej kësaj pike ai nuk mund të shkojë. Në këtë drejtim, kufijtë janë mbyllur. Por moraliteti nuk e shteron dinjitetin njerëzor. Dhe, kur njeriu pushon së vepruari, zbulon natyrën.

Ç'është natyra? Është mbretëria e ndjeshmërisë, është tërësia e gjithçkaje që është trup: është kafsha, bima, fushat e lumenjtë, pyjet e malet, e gjithë toka; por edhe qielli e yjet. A nuk është vetë njeriu një trup? A nuk i jeton ai, në vetë trupin e tij, aq të dashur për të, ngjarjet e vetë natyrës? Sapo të duket dallëndyshja e parë, ai do të hovi menjëherë nga gëzimi, një fije bari që mbin do ta mbushë me habi, furtuna e detit do t'ia trazojë shpirtin dhe perëndimi i qetë do t'i shkaktojë një melankoli të ëmbël e të vagët. Përpara natyrës njeriu zbulon botën e tij të ndjenjave, pra ndërgjegjen e menjëhershme të ndijimeve të tij: një gamë të ndryshueshme, të nuancuar, shumë të lëvizshme, të papërqendrueshme, që polarizohet në kënaqësi dhe vuajtje; e para rrit tonalitetet e të jetuarit, e dyta i dobëson ato.

Mirëpo, a s'ka qenë tashmë njeriu subjekt veprues në lidhje me natyrën? Po, por për të vepruar mbi të, domethënë për ta përdorur si një mjet për qëllimet e tij. Ai ka prerë pemën për të bërë dru, ka vlarë kafshën për t'u ushqyer me mishin e saj. Ka konsideruar çdo gjë që jeton, vetëm ne raport me të, gati sikur gjërat të ishin krijuar për përdorimin e tij ekskluziv: ka lënë pas dore të kërkuarit në to të një kuptimi të pavarur. Por,

tashti që ai e sodit natyrën, kupton se ajo ka një vlerë të sajën: ai nuk mund të mos e vërejë këtë të vërtetë të thjeshtë, mjaft të dëgjojë atë që shfaqet në jetën e tij të ndjenjës. Pse shpirti i tij përmallohet thjesht duke soditur kafshët e bimët? Pse ai dashuron tek ata atë që është e bukur dhe urren atë që është e shëmtuar? A mund të ndiente ai kësisoj, sikur të mos e lidhte diçka me këto qenie, megjithëse të ndryshme me të? Nëse ato janë të ndryshme me të në disa drejtime, janë të ngjashme me të në disa të tjera: një Jetë e njëjtë rrjedh në të gjitha ato, një parim më i gjerë se mendimi, që përmbledh së bashku gjithçka që jeton. Kafsha dhe bima e shfaqin farefisninë e tyre, më shumë apo më pak të largët me njeriun, në jetën e bërë të ndërgjegjshme për vetveten, në formën e vet të drejtpërdrejtë të ndjenjës. Njeriu e ndien errtas që u detyrohet për diçka edhe atyre. Sigurisht, nuk është kjo ndjenja që kemi ndeshur në jetën morale: njeriu ka detyrim vetëm ndaj njerëzimit. Si subjekt moral, unë ndihem i detyruar të respektoj humanitetin e përbashkët që gjendet në çdo njeri. Si subjekt estetik, unë nuk ndiej detyrim ndaj asgjëje: ndihem vetëm *i prirur* të simpatizoj me jetën e çdo qenieje të gjallë. Vetëm solidariteti njerëzor është detyrë; solidariteti natyror është vetëm një nevojë sentimentale. Me anë të ndjenjës, më fort se me anë të arsytimit, njeriu zbulon se ai është prodhim i evolucionit natyror, se kafsha e bima janë tashmë pjesë e tij, se një lidhje e pandashme e bashkon me ta dhe, nëpërmjet tyre, me natyrën e tërë.

Ndjenja e kulluar, pa problemet praktike, që na

përkshon kur vihem në pozicionin e spektatorit përpara natyrës, është ajo që quhet *soditje*. Derisa ne veprimi, emocionet e shpirtit tonë janë pak a shumë të vrullshme. Këtu, përkundrazi, emocionet janë zbutur, nuk është më vala e shkurpëzuar, është dridhja e saj. Kënaqësia këtu është e brishtë, fine, dhe po kështu është edhe dhimbja: gëzim në rastin e parë, melankoli në të dytin. Prandaj, gjatë soditjes shpirti është i prirur të njohë.

Cili është objekti i soditjes? Vetja ime, së pari, dhe pastaj të ngjashmit e mi; por edhe ata të ndryshmit, bimët e kafshët, gjithçka që jeton në përgjithësi. Pastaj edhe çka nuk jeton. Është kënaqësi të sodisësh kuqërrimin e agimit, pasqyrën e detit, llamburitjen e yjeve. Gjithçka që bie nën pushtetin e ndijimit mund të jetë objekt soditje dhe do të shkaktojë tek unë gëzim ose melankoli. Soditja është qëndrimi karakteristik i ndërgjegjes para ndjeshmërisë, është perceptimi që s'ka lidhje me një qëllim praktik, është perceptim *i çnterësuar*.

Nga qëndrimi soditës lind arti. Të ndiesh natyrën, të jetosh në komunikim me të, kjo nuk i mjafton njeriut. A nuk është dhe ai vetë natyrë në thellësinë e vet? Prandaj, ai do të shtyhet të imitojë atë që bën natyra, dhe jo vetëm ta imitojë, por ta vazhdojë e ta përkryejë: sepse ai është gjithnjë shpirt që qëndron mbi natyrën.

Çfarë bën natyra? Për të nuk mund të themi me të vërtetë se vepron, veprimi është aktivitet që zhvillohet kur ka qëllimshmëri, të cilat janë në përfytyrimin, në mendimin. Natyra nuk ka asnjë qëllimshmëri të vërtetë: çka jeton, kërkon vetëm të jetojë.

Natyrë *krijon*: të krijuarit është forma e saj e veçantë e të vepruarit. Krijimi është, së fundi, organizimi i materies bruto në një individ nga ana e spontanitetit jetësor. Krijimi është formimi i formave, duke qenë se materia është një e dhënë fikse e një sasie energjie.

Forma individuale riprodhon formën e species. Individët janë vetëm variacione më shumë ose më pak të theksuara mbi temën e species. Dhe speciet janë ato që shkenca tashmë i ka klasifikuar. Natyra nuk ka pushuar së krijuarit specie të reja: por ritmi i saj është ngadalësuar shumë në periudhën e tanishme, në krahasim me kohën kur specia nuk ishte fiksuar ende, kur nga njëra specie te tjetra tranzicioni ishte i vazhdueshëm e shumë i lëvizshëm. Pasi krijoi speciet e ndryshme të gjalla, Jeta duket sikur është lodhur, shterur. Tashti ajo kufizohet te rikrijimi i asaj që është krijuar më parë. Njësoj si artisti që ka shterur damarin e tij krijues dhe që në moshën e tij më të pjekur *përsërit* vetveten.

Por evolucionit ka krijuar njeriun. Dhe ja, njeriu është spontaniteti që ka thyer rrethin. Përsa i përket njeriut, që është qenie shpirtërore, të krijuarit vazhdon: nuk është më përsëritja e asaj që është krijuar tashmë, është të krijuarit e formave gjithnjë e më të reja që pasurojnë jetën e shpirtit. Sigurisht, nuk është ai që do të krijojë forma të gjalla: njeriu s'është Zoti. Por ai mund të imitojë vazhdimin e jetës, duke i dhënë trajtë materies bruto. Mund të përvijojë linjat e lëvizjes së saj, duke i shoqëruar me një asortiment të pasur ngjyrash. Mund të bëjë më shumë: me anë të tingujve, mund t'ia japë vetë ritmin jetës, duke i kthyer modulimet e ndërgjegjes, dhe të asaj që qëndron poshtë saj, në melodi të ndjeshme. Mundet, më në fund, të përfaqësojë veprimin njerëzor në të gjithë varietetin e koklavitur të tij, duke e bërë të vetëdijshëm për veten me anë të lojës së ndjenjave dhe pasioneve.

Gjeniu artistik është shpirti që vepron si natyrë. Dhe ai është natyrë, sigurisht, përderisa i bën të vetat zhvillimet e saj. Por nuk është imitim vepra e tij, veçse pjesërisht. Madje, në pjesën më të madhe, është fryt i spontanitetit të vet. Duke e paraqitur natyrën, ai do ta *transfigurojë*, domethënë do ta ngrejë në dinjitet njerëzor. Bima që ai do të vizatojë, kafsha që ai do të plazmojë, do të jenë shprehje të përkryera të jetës, por do të jenë edhe diçka më tepër. Ai do t'u *shtojë* atyre diçka nga vetja...

...the gleam

The light that never was on sea or land



Arshi Pipa, e ëma dhe i vëllai. Foto nga arkivi "Pipa"

The consecration, and the Poet's dream¹

Nëse është e vërtetë se çdo gjë që jeton, dëshiron tejkalimin e vetvetes, duke pasur pothuajse një parandjenjë për formën superiore që është specia njerëzore, artisti do ta kapë këtë dëshirë dhe këtë përpjekje, duke theksuar në përfytyrimin e tij disa tipare, pikërisht ato që afrohen me të, si qenie shpirtërore që është. Kështu natyra, me anën e artistit, që e ka bërë si mish të vetin e si gjak të vetin, përmbush në një farë mënyre atë që vetë ajo s'ka mundur ta bëjë: lartësohet në njerëzoren.

Kjo kërkesë ideale është edhe më e theksuar kur objekti i paraqitur është vetë njeriu. Piktori që pikturon një fytyrë, nuk kënaqet duke shprehur mbi telajo fizionominë e saj si një barazim të përkryer: piktura nuk është fotografi. Ai do të kërkojë të verë në dukje disa tipare, me anë të të cilëve mund të shkëlqejë më mirë forma individuale, që të japë qartë, gati të prekshëm, atë spiritualitet të ngulitur në të. Nuk ka artist që ta gjejë natyrën përsosmërisht të përshtatshme me kërkesat e tij: edhe te një Helenë, ai do të dijë të dallojë një defekt të vogël. Kjo kërkesë e thellë e artistit për ta korrigjuar e përmirësuar natyrën, është në fund të fundit një kërkesë morale. Është shpirti që e modelon natyrën sipas vetes, prejse e gjen të papërshtatshme, është tejkalimi i reales dhe pajtimi me idealen që është tek ai. Dhe, po të ndodhë ndonjëherë, shumë rrallë, që artisti të arrijë të marrë një qëndrim gati armiqësor ndaj natyrës (Leopardi, Vigny), le ta kuptojmë këtë si shenjë që ka një domethënie më të lartë: nga dashuria e tepërt, e urrejmë, sepse ajo nuk i përgjigjet idealit tonë, idealit që krijojmë ne për të.

Arti arrin kështu, megjithëse me anë të ndjenjës, atë formë të veçantë universaliteti, që është e bukura artistike, superiore ndaj së bukurës natyrore. Ky është një universalitet më i gjerë se ai i arsyes, megjithëse ky i fundit më i stërholluar. Universaliteti i arsyes imponohet me detyrim; ai i ndjenjës vetëm sipas shijes: presupozon larushinë e temperamentit dhe të humorit, që e kushtëzohet shijen. Çdokush do të jetë i prirur për ta quajtur të bukur atë që i pëlqen atij vetë. Por, nuk ndodh rrallë – dhe kjo ndodh më shumë për të bukurën natyrore, sesa për të bukurën artistike – që një lloj i së bukurës u pëlqen pothuajse të gjithëve. Dhe është ndoshta kjo arsyeja që shpjegon se përse arti klasik është më universal: sepse, nëse nga njëra anë u jep kënaqësi kërkesave ideale të njeriut, nga ana tjetër ai është më afër natyrës se çdo art tjetër.

Jo të gjithë njerëzit janë të gatshëm ta pranojnë të mirën me ndërmjetësinë e së cilës vepron arsyeja: për faktin e thjeshtë se ata nuk arsyetojnë gjithmonë. Por ata do të jenë gjithmonë të gatshëm ta pranojnë të bukurën, t'i bëjnë jehonë të menjëhershme, sepse është e bukura që e bën jetën, madje të gjithë natyrën, që u flet dhe i thërret, e ata s'mund të qëndrojnë të shurdhër ndaj thirrjes së jetës, sepse janë të gjallë.

Nga të gjitha aktivitetet shpirtërore, Arti është ai më i afërt me jetën, është më i përshtatshmi, pra, që t'ia zbulojë kësaj kuptimin. Dhe ja përse: derisa jeta vazhdon të jetë një *sinol* i trupit dhe i shpirtit, kulti i së bukurës do të përbëjë gëzimin më të lartë të njerëzimit, kurse priftërinjtë e saj, artistët, do të rrethohen nga dashuria e përgjithshme.

E mundur gati gjithmonë në planin etik, natyra e kërkon shpagimin e të drejtave të saj në planin estetik. Në planin etik shpirti e trupi rrallë ishin dakord: dhe duhej që ligji moral ta bindte natyrën kundërshtuese, kokëfortë, duke e shtypur dhe ndëshkuar: si një kalorës të cilit i duhet ta zbusë një kalë të egër, para se të mund ta përdorë. Në planin estetik, përkundrazi, ata janë aleatë. Atje ishte natyra që ngrihej në dinjitet të shpirtit, këtu është shpirti që tkurret duke u ribërë natyrë. Dhe ja, të dy shkojnë tashti si miq të mirë. Por duhej që shpirti ta zbusë më parë natyrën, duhej ta mundte, ta fitonte këtë Brunhilde, këtë Circe, duke rrezikuar të përcudnohej, të humbiste. Nga superiorja tek inferiorja: kjo është rruga e drejtë në selinë shpirtërore të vlerave. Me anë të natyrës, nuk do ta arrijmë kurrë shpirtin: përpjekjet e kota të natyralizmit janë provë e



mjaftueshme. Duhet të nisemi nga subjekti – çdo nisë tjetër është e dënuar të mos ketë sukses – nga subjekti që vepron si sintezë e shpirtit dhe e natyrës, për të ndjekur zhvillimin e veprimit deri në maksimalen e shtrirjes dhe të vlerës së tij. Dhe, vetëm pasi të ketë arritur në këtë pikë, vlen të tërhiqet në vetvete, për të zbuluar një formë tjetër spiritualiteti, që të jetë si një vazhdim i tij. Në këtë kuptim, arti është plotësues i nevojshëm i moralit. Aty ku mbaron zotërimi i veprimit, aty fillon fuqia e krijimit.

Kështu, me anën e artit ne depërtojmë në zotërimin e gjerë të jetës, ku njeriu s'është veçse një specie mes specieve të tjera. Me anë të artit kemi kërkuar të gjejmë kuptimin e jetës në përgjithësi. Pengesat janë hapur në këtë anë: kemi provuar se jeta është një parim më përfshirës sesa arsyeja. Nëse kemi humbur në intensitet, kemi fituar në shtrirje. Arti plotëson moralitetin me atë që i mungon, një parfum thjeshtësie dhe natyrshmërie, një frymë që e bën fërgëlluese atë që është shumë e ngurtë dhe e rreptë në jetën morale. Natyralizmi, i mundur në planin etik, është plotësisht i justifikuar në art. E kundërshtuam më parë si të pamjaftueshëm dhe të papërshtatshëm. Por, tashti që kemi mësuar të zbulojmë me anën e artit një formë solidariteti më të gjerë, le të ndjekim rrymën natyraliste dhe të përpiqemi të kapim të vërtetat e saj.



1 Wordsworth: "...shkëlqimin / Dritën që s'qe kurrë në tokë as në det, / Shenjtërimin dhe ëndrrën e Poetit."

Bisedë me botuesen e veprës së Arshi Pipës

IRENA BUZI

Bashkëpunimi me motrat Pipa, një shkollë më vete për mua

Zonja Irena, shtëpia juaj botuese “Princ”, që me librin “Kritika, ese 1940-1944” (2006) e deri më sot me “Trilogjia Albanika”, i ka sjellë lexuesit shqiptar një pjesë madhe të veprës së Arshi Pipës. Madje, me këtë emër të nderuar të kulturës sonë, ju si botuese dalloheni lehtësisht nga kolegët tuaj. A mund të na thoni si ka nisur ky bashkëpunim?

Ju falënderoj për ftesën që më bëtë për të ndarë me ju dhe me lexuesin përjetimet dhe mendimet e mia, me statusin e botueses.

Çka më vrau syrin brenda çështjeve që më shtroni në këtë pyetje të parë ishte mendimi juaj se nëpërmjet botimit të veprës së Arshi Pipës dallohem lehtësisht prej kolegëve të mi. Ndoshta po, por, për hir të së vërtetës, nuk më kishte shkuar mendja se si mund të dukem nga jashtë dhe krahas kolegëve: procesi i botimit të veprës së Pipës ka qenë dhe është fort i lidhur me dashurinë time për qenien e padukshme, dijen, atdheun dhe gjuhën shqipe, duke përfshirë të gjithë izm-at që mund të burojnë prej tyre. Me fjalë të tjera, deri më sot, notova familjarisht kundër rrymës, me një kosto të madhe vetëmohuese. Për më tepër, nuk besoj te kulti i individit.

Puna me veprën e Pipës zuri fill shumë më herët se botimi i librave të parë të Princit. Për parantezë, botimet e para përkujtojnë me librat “Kritika, ese 1940-1944” (2006) dhe “Për Migjenin, tri ese” (2006), të cilët dolën në të njëjtën kohë. Pra, kjo punë nisi në vitet 2000-2001, gjatë kohës që Myftar Gjana, administratori i botimeve, punonte si administrator i Bibliotekës Kombëtare. Në atë kohë, ai nxori nga fondi i Bibliotekës Kombëtare artikuj të shkruar nga Pipa, me dhe pa pseudonime, në revistat letrare të kohës si: “Bota e Re”, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipnisë; “Kritika”, ku Pipa ishte kryeredaktor; “Shkëndija”; “Fryma”, botues i së cilës ishte Myzafer Pipa, vëllai i Arshiut. Ndërkohë, Myftari bënte promovimin e Pipës ndër miqtë e vetë shkrimtarë e gazetarë. Prej këtyre artikujve të nxjerrë, ai që gëzoi popullaritet mes njerëzve të letrave, ishte “Shpirti kritik”, i cili u botua te suplementi fundamental kulturor “Fjala” i gazetës “Tema”, suplement ky i mbështetur nga Mero Baze dhe me kryeredaktor Agron Tufën.

Me Myftarin, siç edhe mund të dihet, u njoha në qershor të 1997-s dhe jetuam e bashkëpunuam deri në mars të 2018-s.

Vitet 2000-2001, në jetën time, përkujtojnë me mbarimin e studimeve në Fakultetin e Arteve të Bukura dhe me një zhytje të thellë në një vetizolim total, i cili zgjati për shumë vite me radhë. Ishte mu kjo periudhë vendimtare, kur kam punuar me orë të zgjatura punë ku ndërthureshin intensivisht krijimtaria artistike personale, leximi dhe përkthimi nga anglishtja në shqip. Midis leximeve ishin edhe shkrimet e lartpërmendura të Pipës.

Myftari, për shkak të natyrës së tij, arsimimit dhe background-it politik e letrar nga vinte, ishte i mirinformuar dhe i bindur që Pipa duhej botuar patjetër. Përkundër Myftarit, Pipa ishte krejt i panjohur për mua. Kështu që, në rrethanat ku ndodhesha, leximi i shkrimeve të Pipës 20-25 vjeçar pati një ndikim të madh tek unë që në atë kohë isha 25 vjeçe. Gjatë periudhës që merreshim me këto shkrime, isha e detyruar t’i kërkoja sime motre (sot Dr. në shkencat kompjuterike) që të më radhiste dorëshkrimet e përkthimeve të mia dhe dorëshkrimet e përkthimeve të Myftarit. Me nxitjen e saj, për gati dy vjet e gjysmë ndoqa kurse ku mësova disa programe kompjuterike. Nëpërmjet mjeshtërive bazë që fitova, arrita të shkruaja dhe përpunoja një tekst të caktuar, si edhe të bëja përpunime grafike aq sa të hartoja një libër.

Këto ishin shkurtimisht parakushtet që Myftarin dhe mua na çuan në krijimin e shtëpisë botuese, më datë 28.06.2005. Me krijimin e entit, nisi edhe puna e vërtetë për radhitjen, korrektimin dhe sistemimin e artikujve të Pipës,

tashmë të grumbulluar. Gjatë kësaj kohe u takuam dhe nisëm bashkëpunimin me motrën e Arshi Pipës, znj. Nedret dhe të shoqin e saj, z. Uran Kalakulla. Djalin e tyre, Platorin, së bashku me familjen e tij, do t’i takonim pak vite më vonë, pasi jetonin përkohësisht jashtë shtetit. Që nga viti 2005 e në vijim familja Kalakulla na priti e përcolli miqësisht në shtëpinë e tyre, duke na treguar dhe vënë në dispozicion një pjesë të madhe të arkivit “Pipa” që ata zotërojnë. Ky lloj bashkëpunimi, personalisht, më ka bërë të ndihem si pjesë e familjes së tyre deri sot e kësaj dite. Pa një miqësi të tillë zor se do të kryeja editimin e lëndës së Pipës.

Vepra e Arshi Pipës paraqet disa vështirësi për një botues si: përkthimi nga gjuhët e tjera ku janë botuar fillimisht, kërkimi në arkiv, sistemimi i materialeve për botim, aq më tepër në mungesë të autorit. Si ia keni dalë që të realizoni gjithë këto botime.

E vërtetë. Përveç dy librave të parë të botuar, të përmendur më sipër, shtatë librat e tjerë që pasuan («Montale dhe Dante” 2007; “Stalinizmi Shqiptar” 2010; “Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste” 2010; “Skicë e një konceptimi mbi jetën (plotësuar me) Mbi Gjenin” 2011, 2020; “Trilogjia Albanika (e përbërë nga): I. *Vargu folklorik shqip: ndërtimi dhe gjinitë*, II. *Jeronim De Rada*, III. *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*” 2013), duheshin përkthyer nga origjinali në italisht dhe ai në anglisht, brenda të cilit kishte raste që ndërthureshin edhe gjuhë të tjera. Gjetja e përkthyesit dhe ujdja me të ishte përgjegjësi e Myftarit. Puna ime fillonte pasi merrja tekstin e mbaruar së përkthyeri deri me shpërndarjen e librit. Natyrisht që në koordinimin e punës midis palëve, në hapat rishtarë të botimeve ka pasur edhe gabime, për të cilat jam bërë e ndërgjegjshme më vonë. Në këtë kuptim, përkthimet dhe botimet e para (2007, 2010) u shoqëruan me entuziazmin ndaj veprës së Pipës dhe me ngutjen për t’u botuar fjala e tij e munguar, gjë që më vonë solli domosdoshmërinë e rishikimit të përkthimit, si edhe të ribotimit. Këtë fat e pati “Stalinizmi Shqiptar”, ndërsa “Montale dhe Dante” së fundmi është futur në proces të rishikimit të përkthimit, i cili gjatë ribotimit do shoqërohet edhe me letërkëmbimin Montale-Pipa. Përveç këtyre të dyjave, “Politika e gjuhës në Shqipërinë Socialiste”, sipas meje, për shkak të qasjes së saj dhe shtjellave të debatit historik mbi standardin, dialektet geqe e toske, ka një ngërc editorial, i cili mendoj se duhet shmangur në një ribotim të mundshëm: pas disa diskutimeve midis Myftarit, përkthyesit Primo Shllaku dhe motrave të Pipës, znj. Fehime dhe znj. Nedret, u ra në ujdë që libri të botohej në shqipen geqe dhe atë të standardit. Dhe ashtu u botua. Pas tij, vijoi puna me botimin e dorëshkrimit “Abbozzo di Una Concezione Della Vita, *Seguita da* Il Genio: Prigione di Burrel, 1955”.



Përkthimi u mor përsipër nga motra e Pipës, znj. Nedret. Përpunimi dhe editimi i lëndës në shqip dhe në italisht ishte një bashkëpunim shumë i mirë ku u përfshi puna e bërë nga Myftari, znj. Nedret, një diplomat italian (mik i familjes Kalakulla), Prof. Dr. Ardian Marashi, Prof. As. Dr. Merita Sauku Bruci dhe unë. Ky botim u kurorëzua me mbajtjen e një konference të mirëfilltë shkencore, të organizuar nga M.Gjana dhe A.Marashi, ky i fundit, atëkohë, Drejtor i Qendrës së Studimeve Albanologjike. Në këtë konferencë kumtuan Mgr. M. Gjana, Prof. Dr. Ardian Marashi, Prof. As. Dr. Merita Sauku Bruci, Prof. Dr. Hysamedin Feraj, Dr. Elvis Hoxha, Dr. Ermal Hasimja, Prof. As. Dr. Mark Marku, Dr. Virion Graçi, Amik Kasoruho (mik dhe nxënës i Prof. Pipës) dhe përkthyesja Nedret Kalakulla. Për aktet konferenciale, nuk u krijua mundësia që ato të botoheshin.

Në lidhje me kërkimin në arkivin “Pipa” dhe sistemimin e materialeve për botim, një pjesë e mirë pune paraprake dhe e mahnitshme ka qenë bërë nga vetë Prof. Arshi dhe një pjesë tjetër, po në atë frymë, ka qenë bërë nga motrat Pipa, znj. Nedret dhe znj. Fehime, bashkëpunimi me të cilat ka qenë si një shkollë më vetë për mua. Përmes këtij bashkëpunimi, që më pajisi me mënyrën e jetesës së familjes Pipa dhe me metodikën e tyre të punës, arrita që të kryej botimin e amanetit të Pipës, veprën “Trilogjia Albanika”, me ndjesinë që, kur punoja, Prof. Pipa mbikëqyrte punën time. Nga kjo lloj klime u arrit të gjendeshin gabime të llogaritjeve metrike ose të ndonjë gabimi të shkrimit në shqip, të shpëtuar gjatë botimit gjerman. Kam bindjes se vepra, në mos tërësisht, është shumë afër vullnetit të autorit. Gjithashtu, ky botim u vlerësua me çmimin Kombëtar të Bibliofilisë, «Lumo Skëndo 2013”, me motivacionin si “një botim që harmonizon vlera të çmuara intelektuale, estetike e bibliofilike, duke pasuruar me hijeshi e dije, Bibliotekën Albanologjike”. Sidoqoftë, krahas vlerësimit të punës sime me shkrimet e Pipës, i kërkoj ndjesë lexuesit për të metat që ndesh, me të njëjtat fjalë që Pipa i citoi nga vepra *Cuneus Prophetarum* (Çeta e profetëve) të Bogdanit, shkruar te *Parathënia* e veprës “Trilogjia Albanika I, Vargu folklorik shqip: ndërtimi dhe gjinitë”:

“Si qua videbuntur casu non dicta latine,

In qua scribebam, barbara terra fuit.”

(Nëse këtu do të hasni ndonjë fjalë që unë ta kem shkruar E latinisht s’tingëllon, në dhe të huaj jetova.)

Para ca kohësh ju botuat edhe një autor të rëndësishëm si Zef Zorba, në 100 vjetorin e tij, apo poetin Frederik Rreshpja. Po ashtu keni botuar edhe një vëllim me tregime të autorëve relativisht të rinj, por që janë nga veriu apo Kosova. A mund ta dimë se çfarë ju tërheq më shumë nga autorët veriorë? Është ky një synim i juaj apo rastësi?

Fillimisht, në lidhje me botimin e veprës poetike të Zorbës, dëshiroj të bëj një sqarim: për shkak të gjendjes së pandemisë, botimi ka mbetur pezull dhe pritet të mbyllet gjatë gushtit. Po nga kjo gjendje, me vonesë arrita të ribotoja veprën filozofike “Skicë e një konceptimi mbi jetën; Mbi gjenin” nga Pipa, vëllimet poetike “Duke kërkuar Itakën” nga Rreshpja dhe “Lule nate” nga Primo Shllaku, projekte këto që zunë fill nga janari i këtij viti. Siç duket, jo vetëm këta autorë, por edhe gjithë autorët e tjerë shqiptarë të botuar nga Princi, përveç Virion Graçit dhe Romeo Çollakut, janë të lindur dhe të rritur në veri, në Kosovë apo Shqipëri qoftë. Sigurisht që ka qenë ndikimi dhe njohja e Myftarit që ka përcaktuar në njëfarë mënyre linjën e botimeve deri në v. 2016. Kjo gjë padyshim që ka ndikuar në formimin tim estetik, aq sa po e shpreh me shaka dhe në mënyrë figurative:

- Po të më duhej të flisja shqip me një ufo, do zgjidhja të flisja në gegnisht, por unë nuk di të flas kësisoj.

- Po të më thuhej “shko në një vend se një qenie e padukshme do vij dhe do të t’japë jetë”, atëherë do shkoja në Prizren.

A mund të na thoni disa nga projektet e ardhshme të botimeve “Princ”?

Me thënë të drejtën nuk e di se çfarë mund të më sjellë jo vetëm e ardhmja, por edhe çasti. Sidoqoftë, ngulem fort te puna e përditshme dhe shpresoj... shpresoj se në të ardhmen e afërt do të botoj librat që janë në proces: “Letërkëmi CAMAJ-PIPA, 1959-1992” gjatë gushtit. Në vijim të tij, “Estetika si shkencë e shprehjes dhe gjuhësisë së përgjithshme: Teoria dhe Historia” nga Benedetto CROCE (përkthyer nga Zef Zorba dhe Alfred Bushi), “Politikë dhe letërsi: paradigma Gramsci” nga Arshi PIPA (përkthyer nga Majlinda Bashllari, me pasthënie nga Hektor Çiftja), ribotimi i traktatit estetik “Mbi Pikturën” nga Leon Battista ALBERTI (përkthyer nga unë), si edhe përmbledhja e gjithë veprës poetike të Lisandër Kolës. Pas këtyre, do të isha shumë e lumtur po të mbaroja botimin e tezës sime doktorale, të cilën e mbrojta në tetor 2019, si edhe veprën “Estetika: Leksionet mbi Artin” nga HEGEL, përkthyer prej meje.

Duke ju falënderuar për intervistën,

i uroj jetë të gjatë e të begatë gazetës “ExLibris”!

NJË VËSHTRIM MBI DY VARIANTET E NJË VJERSHE TË FAN NOLIT

Nga Sevdai Kastrati

Krishti me kamçikun

Sipas “Diellit”

Në kështjellë t’ atdheut, në tempull të fesë
Janë shtruar sarafët pa shpirt e pa besë,
Tregëtojnë e gënjejnë, rrëmbejnë e sfrutojnë,
Thon’ ashtu Israelin e mprojnë e shpëtojnë.

Shtrëmbërojnë kanunet, i marrin në dorë,
Dhe shkëlqejnë në kish’ e në fron me kurorë,
Vegjelia për ta batërdisen dhe vriten
Dhe kështu parasitët gjakpirës po rriten.

Çdo i shenjt’ ideal, çdo shtëpi Perëndie
Ishte bërë dyqan dhe Pazar tregërie:
Kush fitonte më tepër, ay ish usta,
Dhe kush nukë plaçkitte ish krejt budalla.

Tradhëtori dinak, hipokrit e kusar
Kish arrirë në kulm, dhe u-bë kryetar;
Nënë zgjedhën besnikët për vdekje lëngonin,
Se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtonin.

Kur e pa këtë zi dhe këtë errësirë,
Krisht’ i ëmbël u-ndes dhe u-bë i vështirë:
Me kamçik e me vrushkull sarafët i dboj,
Dhe nga korbat q’ e hanin atdhen’ e shpëtoj.

Dhe Shën Pjetr’ i gëzuar ahëre i tha:
“Ja tani e ke nisur tamam, or usta!
Me kërbaç e me këlliç mi ne mbretëro,
Dhe me shkelmë dhe grusht na çliro, na shpëto.”

Jesu Krishti s’ dëgjoj, dhe s’e mori vesh mikun,
Dhe me lot i penduar e hodhi kamçikun,
Dhe i tha: “S’ke fajin kurrizi, po truri,
Se lirin’ e sjell drita e mëndjes, jo druri.”

“Merr-e prapë kamçikun, Shën Pjetri u-përgjeq,
Se përndryshe kjo punë na del mos më keq.
Përkëdhel-u kurrizin dhe do t’ të besojnë,
Vraj-i, shtyp-i, dhe shtrydh-i, dhe do t’ adhurojnë.”

“Je gabuar, o Krisht, që u ke predikuar,
Se të marrët, të shurdhërit s’kanë dëgjuar;
Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin,
Se shpirt-robi s’lirohet askurrë pa drurin.”

Jesu Krishti s’dëgjoj, dhe s’e mori vesh mikun,
Dhe s’u-unj përsëri që ta merrete kamçikun;
Dhe e kapnë kamçikun sarafët për fenë,
Dhe e shëmpnë çlironjësin, fen’ e atdhenë.

Krishti me kamçikun

Sipas “Albumit”

Në kështjellë t’ atdheut, në tempull të fesë
Janë shtruar sarafët pa shpirt e pa besë,
Tregëtojnë e gënjejnë, rrëmbejnë e sfrutojnë,
Thon’ ashtu Israelin e mprojnë e shpëtojnë.

Shtrëmbërojnë kanunet, i marrin në dorë,
Dhe shkëlqejnë në kish’ e në fron me kurorë,
Vegjelia për ta batërdisen dhe vriten
Dhe kështu parasitët gjakpirës po rriten.

Tradhëtori dinak, hipokrit e kusar
Na u-ngrit gjer në kulm, dhe u-bë kryetar;
Nënë zgjedhën besnikët për vdekje lëngojnë,
Se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtojnë.

Çdo i shenjt’ ideal, çdo shtëpi Perëndie
Ishte bërë dyqan dhe pazar tregërie:
Kush fitonte më tepër, ay ish usta,
Dhe kush nukë plaçkitte ish krejt budalla.

Kur e pa këtë zi dhe këtë errësirë,
Krisht’ i ëmbël u-ndes dhe u-bë i vështirë:
Me kamçik e me fshikull sarafët i dboj,
Dhe nga larot gjakpirës atdhen’ e shpëtoj.

Dhe Shën Pjetr’ i gëzuar ahëre i tha:
“Ja tani e ke nisur tamam, or usta!
Me kërbaç e me shpatë mi ne mbretëro,
Dhe me forc’ e me pahir na çliro, na shpëto.”

“Je gabuar, o Krisht, që u ke predikuar,
Se të marrët, të shurdhërit s’kanë dëgjuar;
Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin,
Se shpirt-robi s’çlirohet askurrë pa drurin.”

Jesu Krishti s’ dëgjoj, dhe s’e mori vesh mikun,
Dhe me lot i penduar e hodhi kamçikun,
Dhe i tha: “S’ke fajin kurrizi, po truri,
Se lirin’ e sjell drita e mëndjes, jo druri.”

“Merr-e prapë kamçikun, Shën Pjetri u-përgjeq,
Se përndryshe kjo punë na del mos më keq.
Përkëdhel-u kurrizin dhe do t’ të besojnë,
Vraj-i, shtyp-i, dhe shtrydh-i, dhe do t’ adhurojnë.”

Jesu Krishti s’dëgjoj, dhe s’e mori vesh mikun,
Dhe s’u-unj përsëri që ta merrete kamçikun;
Dhe e kapnë kamçikun sarafët për fenë,
Dhe e shëmpnë çlironjësin, fen’ e atdhenë.

Vjershën e tij të njohur “Krishti me kamçikun” Fan Noli e shkroi gjatë qëndrimit në Vjenë më 1927 dhe e botoi për herë të parë pas 18 vjetësh në gazetën “Dielli” më 26 dhjetor 1945 me pseudonimin tashmë të njohur Robo Rogozhina.

Vjersha “Krishti me kamçikun” njohu dy botime dhe kemi një dorëshkrim autograf. Në të dy variantet e botuara numri i vargjeve dhe i strofave është i njëjtë. Vargu i dytë i strofës së katërt te botimi i parë del:

Kish arrirë në kulm e u-bë kryetar

kurse tek “Albumi” është strofa e tretë:

Na u-ngrit gjer në kulm, dhe u-bë kryetar

Në vargun e katërt të strofës së pestë në botimin e parë del:

Dhe nga korbat q’ e hanin atdhen’ e shpëtoj

në variantin e dorëshkrimit autograf është:

Dhe nga krimbat që hanin atdhen’ e shpëtoj kurse tek “Albumi” që është varianti përfundimtar del:

Dhe nga larot gjakpirës atdhen’ e shpëtoj

Në vargun e katërt të strofës së gjashtë në botimin e parë:

Dhe me shkelmë dhe grusht na çliro, na shpëto

kurse në variantin e fundit del:

Dhe me forc’ e pahir na çliro, na shpëto.

Foljet *lëngonin*, *kujtonin* në strofën e katërt të botimit të parë janë në kohën e pakryer të mënyrës dëftore, kurse tek “Albumi” që është strofa e tretë dalin në kohën e tashme të mënyrës dëftore *lëngojnë*, *kujtojnë*.

Përpos ndryshimeve në vargje nga dy botimet, kemi edhe renditjen e strofave ndryshe: strofa e tretë e botimit të parë tek “Albumi” del si strofa e katërt; strofa 7 bëhet 8; strofa 8 bëhet 9 dhe strofa 9 bëhet 7.

Siç mund të shihet, vjersha “Krishti me kamçikun”



përpos ndryshime në vargje, renditjen e strofave ndryshe kemi mjaft korigjime fjalësh: *vrushkull* te vargu i tretë i strofës së pestë është zëvendësuar me fjalën *fshikull*; *këllëç* te vargu i tretë i strofës së gjashtë është zëvendësuar me fjalën *shpatë* etj.

Ndërsa në vargun e katërt të strofës së nëntë (strofa e 7 tek "Albumi") bëhet zëvendësimi i një fjale tjetër me përmbajtje të ngjashme: *s'lirohet* për *s'çlirohet*.

Fan S. Noli është një nga shkrimtarët e rrallë në historinë e letërsisë shqipe që i ripërpunon vazhdimisht poezitë e tij për t'i bërë krijime sa më të arrira poetike. E, në këtë rreth shkrimtarësh bëjnë pjesë Jeronim De Rada, Zef Skiroi dhe Lasgush Poradeci. Jeronim De Rada *Këngët e Milosas* do ta shkruajë në gjashtë variante dhe do të botohen vetëm tri (1836, 1847 dhe 1873); *Këngët e Sarafina Topias* do të botohen tri herë (1839, 1843, 189798) saqë në botimin e fundit me titull të ndryshuar *Une specchio di umano transito* [Një pasqyrë e jetës njerëzore]; *Skanderbuku i pa-fan* do të botohet dy herë (1872-1884, 1885-1886) saqë në botimin e dytë me titull të ndryshuar *La caduta della Reggia d'Albania* [Rënia e mbretërisë së Shqipërisë] dhe kishte ndërmend ta ripunonte edhe një herë. Zef Skiroi poemën *Milo e Haidhi* do ta shkruajnë në katër variante dhe do të botohen vetëm tri (1890, 1900, 1907); poema *Te dheu i huaj* në botimin e parë (1900) kishte 1328 vargje, kurse në botimin e dytë *postume* (1940) kishte 6260 vargje. Lasgush Poradeci vjershat *Kënga e bilbilit*, *Poradeci*, *Vdekja e Nositit*, *Syt' e varfëruar*, *Marshi i dashurisë*, *Valmi i dashurisë*, *Durimi* etj. janë të shkruar në dy, tre dhe katër variante.

Karakteristikat me të cilat përkon De Rada me Nolin janë zgjidhja dhe shkurtimet e titujve, ndryshimet, plotësimet e veprave të tyre. Kështu, fjala vjen, në poemat *Këngët e Milosas*, *Këngët e Sarafina Topias* De Rada, përmend rangun e lartë shoqërore që ka Milosau si bir i sundimtarit të Shkodrës dhe Sarafina Topia si princeshë e Zadrinës, ashtu sikurse edhe Noli në *Historinë e Skënderbeut* përmend pozitën e lartë shoqërore që ka Skënderbeu si mbret i Shqipërisë, e në botim të dytë si kryezot i Arbërisë. Ashtu sikurse De Rada në botimin e parë të *Këngëve të Milosas* me titullin e plotë në italishte *Poesie Albanesi del Secolo XV. Canti di Milosao, figlio del Despota di Scutari* në botim të dytë del me titull të shkurtuar *Canti di Milosao, figlio del Despota di Scutari* edhe Noli në botimin e dytë do t'i shkurttojë titujt e vjershave: *Anës lumenjve të Babilonisë* për *Anës lumenjve*; *Sofokliu dhe Ferid Asllani* për *Sofokliu*. Poemën *Këngët e Sarafina Topias* De Rada në botimin e tretë do t'i ndryshojë titullin *Një pasqyrë e jetës njerëzore*, ashtu sikurse edhe Noli vjershën në dorëshkrim *Dale moj...* do ta botojë pas 18 vjetësh me titullin *Plak, topall dhe ashik*. Është thënë për De Radën se ndryshimet i bënte edhe në shtypshkronjë, ashtu mund të thuhet se Noli vjershën *Saga e Sermajesë*, kinse e përkthyer nga persishtja prej Namik Namazit dhe e shkruar më 11 shkurt 1963 në Ispakhan, do ta ndryshojë në shtypshkronjë.

Siç është thënë për Zef Skiroin se variantin e katërt të poemës *Milo e Haidhe* e ndryshon, e plotëson në faqet e një kopje të librit të botimit të tretë, ashtu sikurse edhe Noli që do t'i bëjë korigjime, përmirësime të dukshme në faqet e një kopje të librit *Historisë së Skënderbeut* (1921) dhe do ta botojë më 1950.

Në qoftë se me De Radën shëmbëllen në zgjedhjen, shkurtimin dhe ndryshimin e titujve, me Zef Skiroin në ndryshimet, plotësimet në kopjen e librit, ndërsa me Lasgushin përkon me shtimin dhe heqjen e strofave. Në vjershën *Lamtumirë* në variantin e fundit Lasgush Poradeci i shton një strofë të katërt, derisa në variantet e mëparshme kishte tri strofa, ashtu sikurse edhe Noli vjershën antologjike "Rent, or Marathonmak" në botimin e dytë i shton strofën e njëmbëdhjetë. Vjershën *Durimi* në variantin e tretë i heq një strofë, ashtu sikurse edhe Noli vjershës *Sofokliu* në variantin e dytë i heq një strofë.

MBI KRIJIMTARINË E XHEVDET BAJRAJT

POEZI E DINJITETIT MBI GËRMADHA

Nga Shqiptar Oseku

"I lere derën hapur
mbaje dritën ndezur në zemër
që ta di se ku të kthehem"

-Xhevdet Bajraj

i cili u shqua që në poezitë e para si zë original, me gjuhë idiosinkretike e mesazh të emancipuar e të ankoruar në rrymat letrare të kohës. Tri përmbledhjet e tij të para në Prishtinën e pushtuar të viteve 1990 ishin kumtare të një pranie të re poetike; përmbledhja e tretë "Emblema e Vdekjes" (1993) fitoi cmimin e librit më të mirë të poezisë nga Shoqata e shkrimtarëve të Kosovës.

Që atëhere, Xhevdet Bajraj ka fituar edhe një sërë cmimesh tjera, një cmim të dytë të Shoqatës së shkrimtarëve më 2000, cmimin ndërkombëtar të Goliardos për poezi më 2004, cmimet Katarina Josipi më 2010 dhe atë të Festivalit Monodrama në Vlorë më 2013 për dramën më origjinale në shqip, si dhe cmimin për librin më të mirë në panairin ndërkombëtar të librit në Prishtinë më 2015, midis tjerash. Që nga dëbimi nga Kosova gjatë luftës më 1999, kur atij iu dha strehë





letrare në Meksikë, Xhevdet Bajraj punon si ligjërues me orar të plotë i shkrimit krijues pranë universitetit në Meksiko City, ndërsa poezia e tij është përkthyer në spanjisht, anglisht, gjermanisht, polonisht, hungarisht, serbisht, turqisht, sllovenisht, e danisht. Dy botimet i tij të radhës në anglisht, përmbledhja poetike “We Fall Like Children” (2018) dhe drama në vargje “Slaying the Mosquito” (2020), u botuan në përkthim kongjenial nga Ani Gjika e Alice Whitmore tek shtëpia botuese amerikane Laertes Books.

Mirëpo, teoria për ndikimin deciziv të emrit mund të argumentohet edhe me vendlindjen e tij parajsore, qytezën e Rahovecit. Banorët e atjeshëm janë shumica pasardhës të shqiptarëve të dëbuar nga cepet më veriore të Gegërisë, që u shpopulluan nga Serbia më 1878. Ndodhur në mes të artë midis Gjakovës e Prizrenit, Rahoveci ka ngelur në hartë me emërtimin e sajuar sllav Orahovac, shqip: arrishtë, ndonëse atje arrat s’janë kultivuar kurrë. Pokorny Julius, tek Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch (1959) aludon se toka e shndrydhur dhe e lërueshme, në shqip “ara” nga protoindoeuropianishtja “harah”, do t’i kenë dhënë atij vendi emërtimin e vet të parë. Lugina ku ndodhet qyteza e vogël ka kushtet klimatike të Burgundisë franceze, me kombinim të përsosur të diellit e dëborës gjatë vitit. Anët ku është rritur Xhevdet Bajraj janë treva e vetme në tërë Siujdhesën ilirike ku ka gjetur kushtet të rritet si në shtëpi të veten hardhia Pinot noir, ky princ i ndieshëm i Burgundisë. Jo rastësisht, poezia e Xhevdet Bajrajt është e mbarsur me hardhi e musht ujze (rakie) e vere, e histori hijesh që rreken të mbijetojnë emrin e vet, si dhe dëbimet e vdekjet e veta. Këto kanë stampuar si sigla të fatit edhe vargjet e Xhevdet Bajrajt.

Te ExLibris sot, mund të lexojmë për herë të parë pesë poezi të pabotuara nga Xhevdet Bajraj, pjesë nga një përmbledhje në dorëshkrim. Poezia e mirë nuk sajohet dot në vakuum letrar. Kritiku i vëmendshëm letrar te poezia e Bajrajt i ndien ndikimet e emnencave gri të epokës, Ali Podrimja, Fatos Arapi, Vasko Popa, Danillo Kish, Paul Valery, e Caslav Millosh, por edhe ato të lirikëve latin Amerikanë. Vetë Bajraj në një intervistë te Epoka e Re (“Kërkues kokëfortë i parajsës së humbur”, 2019) u referohet autorëve Vincent Huidobro, Juan Rulfo, Juan José Arreola, Carlos Fuentes, e José Emilio Pacheco, si objekt të studimeve të tij. Por lajtmotivi i përsëritur i poezisë së Bajrajt, parajsa e shkretëruar dhe lufta e genies njerëzore për një fije dinjitet mbi gërmadha, të kujton edhe antologjinë e Manuel Monteros (1973) mbi poetët latin Amerikanë që shkruan për drejtësi sociale, Octavio Paz, Juan Banuelo, e Efraim Huerta meksikanë, Alfonsina Storni e Francisco Urondo argjentinianë, César Vallejo e Alejandro Romualdo peruanë, si dhe Gabriela Mistral e Pablo Neruda kilianë. Përmbledhja “Poemas y antipoemas” nga Nicanor Parra (1975) që është përkthyer edhe anglisht është thuase në dialog poetik ndër kohë e hapësirë me opusin e Xhevdet Bajrajt.

KAFE ME NËNËN

Frynte një erë plakë në vjeshtë të lindte
Është ditëlindja e Irfanit të vrarë para njëzet vjetëve
gjethet e pjergullës biejnë
mbi flokët e zbardhura të nënës
ajo nuk sheh mirë
nuk dëgjon mirë
jemi vetëm në mes të parajsës së djegur
derisa ajo në kujtime e saja gatuante bukë për babain
tim
për mua dhe për veten
në Tiranë në banesën e Martin Cukallës
unë pija raki Skrapari me Nexhat Dibrën

Piku një mollë dhe e theu heshtjen
bir
pse disa viteve u mungojnë muajt
Rashë nga qielli i shtatë
në këmbë
si mace që i kishte mbetur vetëm një shpirt
Nga molla e rënë doli një krimb si derr i luftës
që e kishte majmur liria

Pije kafënë nënë
pije
janë vite të krimbura



SHTËPITË E BRAKTISURA

Nga dritarja po e shiqonte qytetin
qiellin Zoti para se ta braktiste
e kishte pastruar me fshisë
kështu që ishte i pastër
si loti i një burri
që po fliste me të vdekurit e tij

Sorrat të majmura krrokërisnin në degët e pemëve
nëpër oborret e shtëpive të braktisura
që shumica e banorëve të tyre kishin ikur
për të mos u kthyer kurrë
dyert i kishin lënë të hapura
çelësat ishin në dyer
dritaret ishin të hapura
që njerëzit nëpër fotografitë e varura në mure
të merrnin frymë



DE NIRON DO TA VRASIN NË FUND TË FILMIT

Mes rrënojave të asaj që dikur ishte parajsë
bën ftohtë
aq ftohtë sa që edhe pemët dridhen
i hedhin frutat
Brenda shtëpisë
nëna po vdes ngadal e ulur në kolltuk
duke e shikuar një film me De Niron

Jashtë
bëhet fushatë politike
janë zgjedhjet
votohet për vrasës
(me dhe pa pagesë)
për hajna
për mashtrues
dhe për skllëvërit e tyre

Hoxha ia fut ezanit kot
kot bien edhe këmbanat e kishës

Zoti na ka trajtuar me dinjitet
duke na dhënë vullnet të lirë
fuqinë për të marrë vendime tona
politikanët nuk na japin këtë mundësi

Nënë
De Niron do ta vrasin në fund të filmit
po dal unë ta pi ndonjë birrë
të lutem për ne të dy
në njërin nga kafenetë e qytetit
mos ke dert
nuk do të pi nëpër rrugët
që mbajnë emra heronjesh të shpifur
sapo mora vesh që në rrugën Shën Nënë Terezë
një vrasës e kishte hapur një tavernë të re
dhe të lutem
lëre derën hapur
mbaje dritën ndezur në zemër
që ta di ku të kthehem



SA HERË E KUJTOJ ATDHEUN

Është ujku i zbutur
brenda një peizazhi të xhunglës urbane
që pikturoi një fëmijë demon
Sa herë e kujton atdheun e parë
brenda gjoksit të tij
zoti i ujqërve të zbutur ulërinë

Kjo këtu është një lule egër
e cila edhe pse për herë të parë ka çelur
këtë e ka bërë në mënyrë të përsosur
Shumë shpesh e kujton atdheun
e kur ndodh kjo
e liron një aromë të përsosur

Ky këtu jam unë
për nevoja të mia e kam zbutur ujkun
dhe lules ia kam dhënë emrin e nënës sime
Sa herë ta kujtoj atdheun
e ndjej mëngën e majtë të vdekjes
duke ma fshirë gjakun nga hunda



KUR BOTA ISHTE TEPËR E MADHE

Mendonte se i duhej të thoshte diçka
në letër
diçka të thellë
por nuk i binte asgjë ndërmend

Pas pak iu kujtua koha
kur luante me këmbë të zbathura
në rrugë
deshi të thoshte diçka në lidhje me këtë
kur bota ishte tepër e madhe
e ëndrrat tepër të vogla
Një sorrë krrokati në dritaren e hapur
uni lirik i tij i zgjati duart
dhe ia nxori kokën me rrënjë

Në pasqyrën në mur trupi i tij dridhej
para se të binte në tokë
pa kokë

Ca muzikantë rruge
e këndonin një këngë që kishte korr sukses
atë verë
të zyrtë

LETËRKËMBIM

MUSTAFA KRUJA – MARTIN CAMAJ

Dy fjalë për letërkëmbimin Mustafa Kruja-Martin Camaj

Në intervistën e dhënë së përditëshmes “Panorama”, më datën 10 korrik 2020, studiuesi i mirënjohur dhe titullari i Katedrës së Camajt në Institutin Albanologjik të Munihut, profesor Bardhyl Demiraj, shprehet kështu:

“E mbyllim më mirë këtë mesele, duke i rekomanduar z. Tare që t’u kushtojë vëmendje edhe memuarëve e shkrimeve që trashëgojmë prej sojit farëmirë shqiptar t’asaj kohe, si Genc Korça, Atë Daniel Gjeçaj, Mustafa Merlika (Kruja) Ton Koka etj.”

Dhe pak më poshtë: *“Raporti i Camajt me Kosovën është pasqyruar qartë në botimin e veprës së plotë të atdhetarit dhe eruditit Mustafa Merlika”*

Letërkëmbimi ndërmjet Krujës dhe Camajt rrok një hapësirë kohe prej katër vitesh (10 shkurt 1954 - 30 tetor 1958), gjithsej dhjetë letra të mbetura, pa marrë para sysh ato që mund të kenë humbur rrugës. Them kështu sepse Mustafa Kruja e ka ruajtur me resë letërkëmbimin e tij dhe e motra, Angela Muka ka përcjellë gjithçka, mbas 34 vitesh, familjes së tij. Nga ajo lëndë e vyer u botuan pesë vëllime me rreth 2500 faqe, me titullin unik “Kuvend letrash me miqtë”.

Letra e parë e shkruajtur nga Kruja mban datën 10 shkurt 1954 e lë të tejdukshme idenë se është një nismë e autorit si përgjigje kundrejt dërgimit atij të vëllimit poetik “Nji fyell ndër male” nga Camaj që asokohe banonte në Beograd. Duket se ndërlidhës ndërmjet gjuhëtarit krutan dhe poetit dukagjinas kanë qënë shokët e Martinit, Zef Nekaj e Genc Korça, me të cilët Kruja kishte një letërkëmbim të gjatë.

Është interesant fakti që letra e parë e Mustafa Krujës fillon me një përgëzim e vlerësim të poetit të ri, për të cilin firmëtari i Shpalljes së Pamvarësisë shkruan: *“talentin t’uej qi premtun shumë e mirë për letërsinë shqiptare”*. Letra mbyllet me pseudonimin Tafë Marleka, që dëshmon kujdesin e dërguesit për të mos i prishur punë studiuesit të ri që punonte në Beograd, dhe ku me shumë gjasa ishte i mbikqyrur, aq më tepër që ndaj autorit të letrës regjimi komunist jugosllav kishte jo pak rezerva.

Eugjen Merlika

Ramleh (Aleksandri), 10.2.54

Zotit Martin Camaj

Zotni i ndershëm, kam marrë me kohë veprën t’uej poetike “Nji fyell ndër male”, e kam kënduem dhe kam admiruem talentin t’uej qi premtun shumë e mirë për letërsinë shqiptare. Kam marrë edhe katalogun e shtëpisë botimtare Mustafa Bakija, në të cilën ishin shkruem me dorë këto fjalë : “Fjalori serbo – kroat – shqyp... do t’ua dërgoj”. Këtë s’e kam marrë. Myftisë i kishte qënë shkruem se me anën e tij m’ishte nisun nji libër, por as ky s’më ka ramë në dorë, e ndoshta ka qënë shi fjalori i premtuem. Sido qi të jetë, un ju falem nderës fort.

Këtu due me folë kryesisht për punën t’uej tepër të vyeshme qi i përket fjalorit të Kristoforidhit. Më ka pasë lajmuem për këtë më së pari e ka shumë kohë Zefi e tash vonë Genci. Ky i dyti më hollsisht e tue kopjuem edhe shënimet qi kishte pasë marrë prej jush mbi atë punë. Më thonte edhe se ju paskeni pasë deshiruem nji sipërshikim t’emin përmbi atë punim. Po flas pra pikë së pari mbi këtë pikë. S’do të kishte as më të voglën rëndësi për mue nëse ky bashkpunim i im do të bâhej me emën a pa emën a me çdo farë emni. Pengesa është nji tjetër, e është e pakapërcyeshme : është largsij’e madhe e jonë prej shoshoqit e vështirsit’e mëdhaja me u marrë vesht me letra e shkresa. Kam qitun pra cekën, si thohet në Shkodër, me ju dhânë vetëm do kshilla, e këtë mund t’a bâjmë me nji shkëmbim 2 – 3 e deri 4 letrash. E po filloj qysh me këtë, tue i a nisun me do parime të përgjithëshme.

1. Rr(j)eshitim’i fjalvet mbas alfabetit. Auktori ka ndjekun rendin e alfabetit grek me të cilin ka shkruem. Ka shumë gabime në rreshtim. Ka fjalë të përmënduna si sinonime të nji tjetre e të paregjistrueme në rendin alfabetik. Pra ju duhet me përpiluem nji skedar të ri. Këtu do të ju porosis edhe me ndrequn, ju i pari, nji gabim të çuditshëm qi kanë bâmë të tânë fjalortarët e shqipes njâni mbas tjetrit, s’më bie ndër mnd mirë nëse duhet me përjashtuem apo jo Meyerin. Tingujt e përfaqsuem prej dy shkrolash ase prej nji shkrole me shênj të damë mbë vete, i kanë radhuem si shkrola mbë vete, gjâ krejt antiracionale qi s’e ka asnji gjuhë tjetër, qi njoh un nemose. Abecej’e shqipes s’ka 36 shkrola, por vetëm 26 e mbi këto duhet me e bazuem rrjeshtimin alfabetik të fjalvet. Janë : a b c ç d e

f g h i j k l m n o p q r s t u v x y z. Kështu kanë bâmë italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja e anglishtja. Frëngjishtja ka përjashtuem edhe ç-në tue e vûmë në radhën e ç-së; por un, për shqipen, kujtoj se mbasi ç-ja është nji figurë e dallueme prej ç-së me nji bisht nën të, mù sikur j-ja prej i-së, duhet të zânë vënd si shkrolë më vete. Por jo kështu ë-ja, tek e cila dy pikat nuk janë tjetër veçse nji shênj diakritik njipërnji si theksat : nëse ë-ja do të përjashtohet prej rendit t’ë-së, pse mos të përjashtohet edhe â-ja nga a-ja?

2. Kristoforidhi është plot me gabime shtypi gjithë farësh, të cilat kanë hýmë edhe te fjalorët e tjerë, mjerisht, pa u kuptuem. Natyrisht, po flas për ato gabime fjalësh qi s’janë të njohuna unji. Për këto është pun’e vështirë me ju kshilluem



kritere të përpikta. Nji kishte me qënë me pasun fjalorë të tjerë: Meyerin, Bashkimin, Cordignanone, Leottin, Mann-in e sidomos të parin e të mbrapmin.

3. Mbasi doni me ruejtun shênjet diakritike t’Autorit, duhet t’a tfilloni zyren e tyne, ashtu sikur po shoh në shënimet e jueja, marrë prej Gencit, për dy hundoret.

4. Kujdes në përkthimin e greqishtes shqip ase frëngjisht te ato fjalë që nuk i dini vetë, tue marrë para sýsh se shumic’e fjalvet kanë secila më se nji kuptim, e mund të merrni prej kuptimeve të ndryshme të greqishtes atë qi s’e ka aspak fjala shqipe.

5.“Çdo fjalë kryesore shqipe është e përkthyme në gjuhën frëngjishte...” thoni në shënimet t’ueja. Natyrisht m’asht e vështirë me e kuptuem se ç’farë fjalësh keni cilsuem ju me epitetin “kryesore”. Un kisha me e kufizuem përdorimin e frëngjishtes : a) si ndihëmtare kudo qi vetëm përkthimi shqip i greqishtes nuk ju ngîn për t’a bâmë fjalën t’onë krejt të kuptueshme; b) ke çdo fjalë shqipe qi, tue mos u njohun mirë, i a ka lëshuem vëndin ndonji neologjizme.

6. Sinonimet qi do të shtoni prej fjalorësh të tjerë duhet të kenë ndër kllapa edhe emnin e autorët prej të cilvet i keni marrë.

7. Ç’farë frazeologjish e shëmbujsh keni “spjeguem në gjuhën shqipe me fraza e fjalë ekuivalente simbas spjegimit grek të Krist.”? Bie fjala Autori ka prûmë nji frasë shqipe për tfillimin e fjalës edhe atë frazë e ka përkthym edhe greqisht ; natyrisht, këtë greqishte ju s’keni për t’a përkthym edhe nji herë tjetër. Por do të thoni ndoshta qi Autori ka p.sh. nji proverb a ligjëresë (locution) shqipe e këtë e spjegov, jo me nji përkthim të thatë greqisht ashtu fjalë për fjalë, por disi më gjatë, e ju keni përkthym këto spjegime.

8. Çdo emën shtëaze ase bime jo të njohun mbarë në Shqipni, do të bâjshi mirë e do t’ishte më lehtë për juve vetë me e spjeguem me ekuivalenten frëngjishte e mundsisht edhe me emnin shkencor latin.

Për tash këto janë kshillat qi mundem me ju dhânë. Jam gjithmonë gati me ju ndihun me ça të mundem e me ça të më lypni. Adres’e ime rrin gjithmonë ajo qi keni përdorë: Fuad Salih Myftija – Camp de César – Rue Omirolis, 6 – Alexandrie.

Këtu ka qënë botuem nji “Abetari i të Mërguemit” e mue më ndodhet nji copë me disa faqe mangut. Po ju a dërgoj, jo për vlerën qi mund të ketë nji abetar për juve, por vetëm për gjuhën shqipe qi përdor autor’i veprës, e për disa mendime të tij rreth ksaj gjuhe.

Genci dëshiron nji copë të Fyellit t’uej.

Mund t’i a çoni nëadresën t’eme e un s’kam me pasun vështirsí me i a dërguem atij.

Me shumë shëndet e urime të përzëmërta për punët e çmueshme gjuhsore e letrare.

Tafë Marleka

~

Fort i dashuni mik,

Mora letrën t’uej të datës 13 – III – me të cilën më lajmërojshit se u kanë ra në dorë fjalorët. Jam habitë si nuk u paska ra në dorë nji letër e ëme shumë e gjatë, si gjegje e letrës s’uej të datës 10 – II – të këtij vjeti. Këtë letër u a kam pasë nisë tri dit para nisjes së librave. Sigurisht ka me u ra në dorë, por për më sigurí pikat e asaj letër tash po u a rrjeshtoj kah fundi i kësaj.

U falnderoj dhe unë për abetaren, pse gjuha e saj është shumë interesante. U mbusha mendësh më tepër në nji fjalë të Dr. Bariç mbi Kristoforidhin : - *On je vaš Vuk Karadžić*. Këtë e tham për arsye të qindrimit t’uej kundrejt autorit në fjalë. Më intereson dhe mendimi i juej mbi fjalorët qi muerët dhe njikohësisht jam shumë i kënaqun që u kenka bâ qejfi për ta. Çdo gjâ që të më marrë mendja se është me randësi nga botimet këtu do të u a dërgoj – natyrisht sa të kem fuqi xhepi. Kurrfarë shpërblimi nuk due nga ju, të vetmen nderë që kisha me u a lypë është kjo : në qe se keni ju në bibliotekën ndonji kopje më tepër të fjalorit të Man – it dhe ma dërgoni kisha me u a ditë shumë për nderë. Miqsisht u a la amanet

: vetëm në qe se keni një copë më tepër, pse nuk dishroj që të harxhoheni – tue marrë para sysh kushtet ekonomike në të cilat jetojmë. Amanetin pra e mban edhe toka e s’kam çka me u thanë më. Për kritikën gjuhsore dhe letrare, të cilat u paskan ra në dorë nuk di çka me u thanë as unë. Në këto punë d.m.th. në polemika gjuhsore e letrare shqiptarët janë të njajhtë gjithmonë, natyrisht me pak përjashtime. Ndoshta pse fillestarët i marrin punët gjithmonë me pasion. Këtu në Jugosllavi është interesim i madh në lamën e gjuhsis shqipe. Pushteti i këtuhi ka dhanë dhe jep mundësinë financiare, por ne nuk kemi ende kuadër të pjekur. Me kohë jam i bindun se do të bëhet edhe më tepër, pse vullneti nuk mungon.

Tash due t’u vë në dukje punën t’eme mbi fjalorin e Kristoforidhit, shkurtimisht. Atë punën e parë, d.m.th. përkthimin e fjalorit në gjuhën frëngjishte, e kam braktisë, por munda nuk më ka shkue dam, pse kam xanë diçka për vehte dhe tash një vjetë intensivisht punoj në mënyrën që po u a parashtoj :

I /. Transliterimi i pjesës shqipe tue i rrujtë të tana cilsinat ortografike t’autorit, me përjashtim të ndreqjes së gabimeve të shtypit – këtë e kam bërë vetëm atëherë kur kam qenë qind përqind i sigurtë se është gabim shtyp.

II /. Radhitja e fjalorit si mbas alfabetit t’onë të soçëm – pra kam bërë një skedar të ri.

III /. Pjesën greqishte e kam lanë krejt ashtu si është.

IV /. Aty ku autori e ka shpjeguar një fjalë shqipe me një asë më shumë fjalë greqishte, këta e kam përkthyer shqip tue e vu (përkthimin) ndër kllapa me germa të dallueshme, bri tekstit greqisht. Gjithashtu kam përkthyer terminologjinë gramatikore, të cilën Kris. e ka greqisht me termina ndërkombtar – latin.

V /. Aty këtu ndër kllapa me germa të vogla kam shtue dhe disa sinonime; këtë e kam bërë vetëm në ato raste ku Kris. e interpreton një fjalë në një kuptim të vet specifik. (...)

Shpresoj se letra e parë e eme, ku u kam shfaqë gjanë e gjatë punën tëme ka me u ra në dorë, kështu që do të shifni më kurtë punën. Pra unë kam për qëllim me bërë një ribotim të fjalorit të Krist. në mënyrë që të kuptohet nga masa e shqiptarve. Si i këtillë është parapa dhe në planin e botimeve të sivjeshëm. Ju mbi këtë punë mundeni me më dhanë këshillat më të vlefshme dhe çka është kryesore mund të gjykoni a vlen a jo një gjë e këtillë. Jam shumë mirënjohës për këshillat e letrës së parë. Kurkush deri më sot nuk më ka folë mbi këtë punë më me kompetencë se ju. Në fjalorin e Krist. ë-ja nuk është e veçuar nga e-ja. Habitim se si në fillim të Ungjillit Kristoforidhi i dallon; a thue do të jetë kjo pikpamje e editorve të fjalorit apo e vetë autorit? Për hir t’origjinalitetit as unë nuk i kam dallue dhe tash jam kryekëput i mendimit t’uej. Këtë gjë do ta vë në dukje në fillim asë në hymjen e fjalorit, tue citue dhe Abetarin.

Jam i bindun se kjo punë ka me dalë me të meta, por shpresoj se tue u vu në rendin e ditës Kristoforidhi bëhet një shërbim. Me kohë mundet të dalë ndokush tjetër më kompetent me bërë një botim të tretë, por jam i mendimit se redaktimi i këtij fjalori është shumë i vshtirë, prandaj kisha me thanë se është më e mirë me e paraqitë kështu, sot për sot. N’anë tjetër ju mbi këto gjana mundni me folë shumë më mirë se çdo kush, në të vërtetë edhe si keni folë, prandaj tue ditë dëshirën t’ujë që të dalë sa me faqe të bardhë kjo punë, jam i sigurtë se keni me më këshillue si duhet.

Përfundoj tue u dërgue të falat më të përzemërta.

Beograd 19 – III – 54

Martin Camaj

~~~~~

Mik i dashun,

Letra e Juej dt. 23 mars ka mbërritë gadi para një mueji në Beligrad, por unë nuk u gjindsha këtu. Kam dalë jashta Beligradi tash dy muej për të mujtë me punue në fjalor, qetësisht, prandaj letra e Juej në dorë t’eme ra para gjashtë ditësh. Ju falnderoj shumë për këshillat e nevojshme si për fjalor si për at gabimin e U dhe JU. Ju e dini se në shkollën Saverjane, ku kam mbarue gjimnazin, kjo trajtë na mësohej në kohë po ashtu si thoni

Ju, por Kristoforidhi më ka bërë me e ndrrue. Kam vu oroe se këtu paska hy në modë kjo formë. Aman sa keq kishte me mardhë po qe se ky gabim ka hy edhe në poemthin!

Para do ditësh pashë një përkthim t’Uejin, të librit të Gjorgjeviqit mbi ne. Unë njoh shumë mirë të nipin, një djalë shumë inteligjent me mendime kryekëput kosmopolite. Qesh dhe e ven në lojë gjyshin për naivitetin e tij. Ma ka provue me fakte se familja e tyne është origjinë shqiptare dhe se llagapi i tyne nuk është Gjorgjeviq por FURKA. I pari i tyne ka pasë shumë dele, është martue me një vllahe dhe ka fillue me u marrë me tregti, tue lanë kështu blegtorinë dhe bjeshkët e Nemuna. I nipi habitet si ka mujtë me folë ashtu kundra vehtes Vladani. Ai merret me psikologji dhe fillon me e shpjeguar në mënyrë.

Fjalorin e Kristoforidhit e kanë parapa në planin e botimeve si ribotim, prandaj jam lëshue me të tana forcat me e përgatitë sa më parë. U gëzoja kur lexova në letrën t’Uej se dhe si botim i dytë po qe se përgatitet ky fjalor bahet punë e madhe. Përvoja tri vjeçare në këtë punë më ka vërtetue se më e mira punë që mund të bahet për Kristoforidhin është kjo. Në këtë letër po ju dërgoj një fletë të punimit, pa e zgjedhë që të jetë tipike, bile faqen që e kam përdursh në vijim të punës. Prej kësaj faqe keni me pa kurtas punën që bëj, por po ju rrjeshtoj dhe disa parime të cilave u jam përmbyjtë:

á) Transliterimi besnik i origjinalit; ß) Renditja e fjalëve si mbas alfabetit t’onë të soçëm, ose kam bërë një skedar të ri; γ) ato gabime, që duken se janë fare gabime shtypi i kam ndreqë; δ) Kristoforidhi nuk ka një sistem të caktuem në shenjat e pikzimit, unë jam mundue me mbajtë një sistem; e) Terminologjinë gramatikore fjalori e ka në gjuhën greke, unë e kam përkthyer në latinisht; ζ ) në disa vende auktori ( p.sh. në faqen 140 fjalë KAMSHË asë fjalë DALLANDYSHË-A faqe 91 etj) si gjuhë shpjeguese përdor vetëm greqishten, në këto raste për bri tekstit grek vë dhe përkthimin në gjuhën shqipe (ndër kllapa me germa të vogla). Në disa vende ndër kllapa kam shtue dhe disa sinonime, gjatë ndër fjalorë të tjerë por këtë e kam bërë fort rrallë. Këtë përkthim e kam bërë në mënyrë që fjalori të jetë sa më i përdorshëm në shkollat shqipe këtu, ku greqishten nuk e kuptojnë; η) Shenjat fonetike, në fjalor janë fare në rregull, unë i kam lanë ashtu si janë.

Ju lutem fort për çdo gjë, që të mos ju pëlqejë më lajmroni sa më parë. Këshillat e Jueja do t’i marr para sysh se me të vërtetë kurkush deri më sot nuk më ka folë me kaq kompetencë mbi këtë fjalor. Të jeni të bindun se sot asë nesër (bile kam me u mundue në parathanien e fjalorit) të çfaq



botnisht ndihmën e Juej. Jam vetëdijës se për këso punësh jam ende i papjekur, por nevoja bën që magjypi t’i dalë zot Dinit.

Gencit shumë të fala. Poemthin do të ja dërgoj. Këtë vjetë do të shtypi një kolekcion poezish, të cilat G. kanë me i pëlqye më fort se Fyelli. Po u intereson poezija e eme shumëkuj këtu, por po më kritikojnë si anakronist në tematikë: POLITIKA në numrin e një Majit. Ju përshëndes me nderim.

Beligrad 12 – V – 1954

Martin Camaj

~~~~~

Fort i dashuni mik,

Mora letrën t’uej dt 14 – VII – 1954. Tash e mora vesht se më paskeni pasë dërgue dhe një letër mbi çka ju kam pasë pyetë dhe e cila nuk më ka ra në dorë. Nejsë! Prej kësaj po marr vesht se si ju mendoni që të botohet fjalori i Kristoforidhit. Kjo mënyrë më pëlqen shumë, por për mue është shumë vshtirë me e redaktue Kristoforidhin, pse më së parit nuk e ndiej vedin aq të fortë për një punë të këtillë, së dytit dhe po të kisha fitue një përvojë aq të madhe tash katër vjet, ç’kur punoj në këtë fjalor, mbi Kristo., po shof se, si i ri që jam, kam duert e lidhuna. Qe p.sh. kam hjekë të zit e ullinit me e mprojtë pikpamjen e sugjerueme nga ju mbi E-n dhe E-n. Pra Instituti albanologjik, me të cilin kam dhe kontratën për botimin e fjalorit, lyp kategorikisht që fjalori i Kristoforidhit të shtypet si ribotim asë si botim i dytë pa kurrfarë redaktimi posë ndreqjeve të gabimeve të shtypit. Pra puna e eme në këtë fjalor mbetet si përgatitë e leksikonit të Kristo. për botimin e dytë. Instituti, i sugjerueme nga Riza kryesisht, më ka dhanë autorizimin që të paraqes bashkë me punim dhe një studim të gjatë mbi të metat dhe meritat e Kristoforidhit dhe me ç’kriter kritik do të merret vepra në fjalë. Prandaj shumë mendime t’Ueja mbi Kristoforidhin, të shprehuna në revistën Leka dhe me letra kam me i përdorë në këtë studim. Pikpamjen e E-s dhe E-s do t’a mproj deri në fund pse më duket e drejtë. Studimin e kam menduar me e shtruar mbas metodës së Mario Roques, që ka praktikue në studimin e bëmë mbi Bardhin, natyrisht tue i a përshtatë natyrës së veprës së Kristoforidhit. Këtu kishit mujtë me ndihmue pa masë, sidomos mbi parimet gjuhsore të Kristo., tue marrë parasysh dhe influencimin e tij nga greqishtja.

Kam marrë shumë shënime gjatë punës. Shof se një farë Simon Shuteriqit paska qenë shumë i entuzjazueme bash për këto influencime greke. Xhuvani shumë gjana asë pikpamje të Kristoforidhit i ka paraqitë si të vetat (deri sa ai nuk thotë se kështu ka mendue dhe Krist.).

Në këtë punë dishroj me qenë i drejtue nga ju dhe këtë ndihmë, me e ditë se bëhet deti kos, do t’a shfaq botnisht. Pasunin gjuhsore t’Uejën, të mbledhun me decenje tue ju kushtue mund dhe kohë, duhet me e çmue. Fjalën e vet objektive kanë me e thanë mbi këta vetëm brezat e ardhëshme, me pa ansë të plotë, por edhe na, me sa mundsi kemi, do të mundohemi me ju a njoftë, pse, si fillestar, unë po e shof se sa mund i madh e kujdes u deshka në këto punë.

Në këto ditë del nga shtypi një libër i vogël vargësh prej meje me titull “ KANGA E VËRRINIT”. Mbrenda jave do të ju a dërgoj bashkë me disa libra të Selman Rizës dhe katalogun e Shtëpisë botuese MUSTAFA BAKIJA. Djali i Korçës më ka pasë premtue një libër dhe s’më dërgoi. Shumë ju falënderoj për fjalorin e Mann-it, të cilin e mora. Por ndera më e madhe për mue asht përvoja dhe këshillat shkencore, të cilat i çmoj shumë. Pra, tue pasë parasysh dhe një fjalë t’Uejën: “dhe një botim i Kristoforidhit do me thanë shumë”, do të jem i kënaqun dhe me kaq. Mbrenda njëzet ditësh kam me ju dërgue edhe nr. Jubilar të Jetës së Re, që do të dalë për së shpejti. Në katalog shikoni dhe për çdo gjë që ju intereson më shkrueni.

Ju përshëndes me nderim e miqsisht.

I Jueji

Martin Camaj

M. Camaj: Via delle Azalee 128/35 Centocelle – Roma

Mbi librin e Anton Berishajt, “Fenomenologjia e vdekjes”

VLERA ESTETIKE E FENOMENOLOGJISË SË POEZISË

nga Ndue Ukaj

Historia e letërsisë tregon se shkrimtarë të mirë janë ata që dinë të bëjnë zgjedhje estetike individuale, origjinare dhe të veçanta. Ka të tillë që ia dalin dhe krijojnë universin e tyre estetik, por ka edhe të tillë që mbytn në mjegullnajën e imitimeve skematike letrare. Poeti Anton Berishaj në librin me poezi “Fenomenologjia e vdekjes” që është ribotim i librit me titull “Lule mëngjesi” (1986), ia ka dalë të bëjë një zgjedhje estetike individuale dhe origjinare, gjë që vërehet në formë, tematikë dhe sidomos në strukturën e brendshme të poezisë, në të cilën, çdo tingull, figurë, imazh, mendim është peshuar dhe menduar mirë. Duke dashur të shkruajë diçka të veçantë, autori ka arritur me mjeshtëri t’i ikë traditës së vjershërimit shqip dhe me intuitë e dije letrare ka krijuar modelin e vet cilësor dhe origjinar të ligjërimit poetik.

Poezia, sipas Harlod Bloom-it “është kurora e letërsisë imagjinare”, sepse është një mënyrë profetike e shprehjes dhe si e tillë përmban aspekte esenciale të ekzistencës njerëzore. Ajo shfaqet nëpërmes simboleve, zërit, imazheve dhe gjuhës së kondensuar, me të cilat tipare qëmtun natyrën dhe kuptimin e ontologjisë së ekzistencës, të njohjes dhe përjetimit të dukurive personale dhe impersopnale. Si e tillë, poezia e sërës së lartë të lexuesi nxitë dhe provokon përjetime të forta emocionale, intelektuale dhe kulturore, dhe njëkohësisht para tyre çel horizonte të reja për t’i kuptuar fenomenet e jetës dhe të vdekjes, të dëshirave të ndërgjegjshme dhe të pandërgjegjshme, fenomene këto rreth të cilave është shkruar libri poetik “Fenomenologjia e vdekjes”.

Shprehja se asgjë nuk është e huaja për artin, gjen kuptim në vepra të mëdha, çfarë është kjo përmbledhje poetike e strukturuar në dhjetë libra dhe e kategorizuar në cikle të veçanta. Libri është shkruar me dashuri të madhe dhe me inteligjencë të pashembullt krijuese, dhe aty ndihen pulse të forta artistike dhe mendime të thella filozofike. Duke e lexuar këtë libër, lexuesi e kupton sa të drejtë kishte babai i psikanalizës Sigmund Freud, kur thoshte se: “kudo që shkoj gjej se përpara meje aty ka qenë një poet”. Në fakt, duke i dhënë këtë atribut të madh poezisë, Freud-i sigurisht mendonte te kapacitetet e poezisë dhe te intuita e poetëve për t’i shprehur dhe thënë disa gjëra në mënyrë krejtësisht origjinare dhe të papërsëritshme, ashtu siç ka bërë poeti i këtij libri. Duke ia njohur kapacitetet infinite poezisë, shkrimtari i madh T. S. Eliot, shkruante se “poezia është forma më e lartë e aktivitetit intelektual”. Te ky libër, aktiviteti intelektual është i harmonizuar mjeshtërisht me atë estetik, erudicionin letrar, tensionin e bukur poetik, ku fenomenet e jetës dhe të vdekjes, hulumtohen në dimensionet e tyre ontologjike, ku nyjëtohen kohë e hapësira, përvoja dhe gjakime, libra dhe rrëfime, e ku dukuritë e jetës, të mira e të këqija, transfigurohen dhe transformohen në dukuri estetike dhe poetike, dhe rrjedhimisht në ide dhe mesazhe intelektuale.


Kjo poezi vjen si tipologji vetë-njohje, si *gnosis*

dhe kërkim antropologjik i ekzistencës njerëzore nëpër sferat e jetës, të raporteve ndërmjet gjësë dhe asgjësë, thelbit dhe cektësisë, madhështisë dhe shëmtisë, harmonisë dhe disharmonisë, dritës dhe errësirës, që për ekuivalencë kanë dyzimin e ankthshëm, jetë dhe vdekje. Poeti personalen mjeshtërisht e artikulon si klithmë impersopnale, ankthin si kërkesë intelektuale, kurse nacionalen si thirrje universale dhe kështu tregon se “poezia nuk është art....por qëllimi ynë antropologjik” (Josif Brodskij)

Për të sendërtuar poetikën e vet estetike, autori shfrytëzon mjeshtërisht dy elemente të fuqishme: paradoksin dhe kontrastin. Libri hapet me vargje të forta, ku jeta vihet përballë vdekjes, si dyzim, si paradoks dhe kontrast, meqë ai u këndon:

hijeve shpirttrave
dhe
L
as e vdekur
as e gjallë

Po ashtu, libri përmbillet me vargje lakonike, ku përsëri kemi paradoks dhe kontrast, meqë rishtas kemi dyzimet jetë dhe vdekje:



kjo shtyllë antike
që do të thotë jetë
vdekje që do të thotë
kjo shtyllë antike
(Autobiografia)

Në të vërtetë, dyzimi jetë/vdekje, që është sinonim i dyzimit dritë/errësirë e përshkon në tërësi këtë poezi, ashtu siç është dyzimi dashuri/mungesë dashurie, harmoni/disharmoni. Kështu, ky dyzime, bëhet kyçi i këtij libri dhe shtrihet edhe në rrafshet historike e kulturore, filozofike e religjioze, për t’u shndërruar në një lloj paradigme semantike e stilistike.

Poeti, me vetëdije e shtrinë qëllimin letrar dhe intelektual në fushën e domethënieve dhe kuptimeve letrare filozofike përbrenda dyzimit jetë/vdekje, në hapësirën e së cilës, jeta shtrihet në tërësinë e saj dhe shfaqet si pragu ku drita zhduket dhe shfaqet errësira. Duke e qëmtuar esencën e fenomenologjisë së jetës dhe të vdekjes, ndarja mes këtyre dy botëve ngjan me rrathët narrativ dantian, meqë gëzimi dhe trishtimi duken e zhduken, përplasen, ecin paralelisht, ballafaqohen dhe sfidohen. Dhe poeti është i vetëdijshëm se një botë antipoetike që ngarendë pas marrinave dhe padrejtësive, nuk është e prirur të ndërtojë pallate të bukura, humane dhe me shumë dritare, prandaj ai shkruan përmallshëm, kurse dëshirat e tij hyjnë në rrafshin e lirisë imagjinare dhe tingëllojnë si dëshira estetike, siç ngjet në poezinë “Akool IV”, ku gjakimi për këtë pallat të bukur e me shumë dritare, transformohet nëpërmes simboleve të forta dhe të qarta. Thirrja poetike bëhet në trajtën dëshirore, meqë duket se bota është aq dehumanizuar dhe nuk i pëlqen pallate me dritare:

o sikur ta ndërtoje një pallat të bukur
me shumë dyer me shumë dritare
sikur të ndërtoje diçka të bukur
ndonjë pallat të argjenditë
me shumë dyer
me shumë dritare
ti e di se gjithçka do të mund të ishte ndryshe
o sikur të ndërtoje një pallat të bukur
të bukur
dhe
me dritare

Ndonëse bota duket e verbër dhe e shurdhër përballë këtyre thirrjeve, gjakimi i poetit për ta

thënë të vërtetën është zhuritës. Kjo kërkesë dhe ky dimension shtrihet në gjithë poezinë, kurse me merr një përmasë të fuqishëm të vjersha “*Odë trimërisë*”, ku poeti bën një blatim poetik për të vërtetën, një gjakim të zjarrtë për një fjalë:

*sikur ta thosha
në fjalë
nga zjarri i zemrës
nga drita e shpirtit
nga terri i jetës*

*për flatrimin e zogut në qiell
për ditën që duhet patjetër të vijë
për rrugën që askund nuk shpie
dhe
për të vërtetën
vetëm një fjalë*

Dyzimi semantik, *jetë/vdekje, dritë/ errësirë*, te poezia “*Gota e zbrazët*”, shfaqet në formë tjetër, si dyzim *njeri/jo njeri*:

*se për ty s’ka kurrfarë rëndësie se ndoshta je njeri
se për mua s’ka kurrfarë rëndësie se ndoshta jam njeri*

Qenia e semantike dhe estetike e poezisë

Temat themelore që e përshkojnë këtë libër lidhen me pyetjen ekzistenciale për të kuptuar domethënien e qenies (M. Heidegger) dhe kjo shtrohet në këngët e çuditshme, në ato me karakter filozofik e metafizik ose me motive dashurie, në gjëra dhe sende, dhe kudo ballafaqohet qenia dhe mosqenia, jeta dhe vdekja, drita dhe errësira, nëpër të cilat beteja është farkëtuar jeta e njeriut që nga zanafilla, por edhe qenësia semantike e kësaj poezie.

Për të sendërtuar dhe artikuluar qëllimet e veta poetike dhe për t’i përçarur mesazhet intelektuale, autori me vetëdije krijuese e stilistikë të arrirë i ka ikur stilit të një *njëtrajtshëm* dhe ka ndjekur këshillën e mëdha të Nikola Bualos, që thoshte “*Lum kush di, në vargje, me një zë të lehtë të kalojë nga një ton i rëndë në të ëmbël, nga komiku në të rreptin!*” Anton Berishaj, lëvizjet, zhvendosjet i bënë me lehtësi, kështu që, gjuha në vargun e tij shquhet për lëvizje të lehta dhe të shpejta, zhvendosje befasuese, që bëhen nëpërmes lojës së fjalëve, përsëritjes dhe zhvendosjes së tyre në fjalë, nëpërmes aliteracionit, asonancave, personifikimit, me çka fjalët rikuptimësohen dhe shfaqin ambiguitetin e gjuhës dhe të mendimit, elemente këto stilistike që lexuesin e mbajnë në tension estetik të vazhdueshme.

Poeti evokon, percepton ose rrëfen për fenomene tokësore dhe qiellore dhe përdorë figura të gjetura të mendimit, metafora, simbole, por gjithnjë duke e parapëlqyer kontrastin dramatik dhe dyzimin semantik.

Duke e njohur misionin fisnik të artit në shoqërinë njerëzore, ai poetët i personifikon me zogjtë lajmëtarë të pranverës, tingujt e të cilëve janë sinonim i gjallimit:

*erdhën
për të kënduar
ata erdhën një nga një
si zogjtë si zogjtë*

Por, pas këtyre tri vargjeve, kemi tri vargje tjera, befasuese meqë disa poetë ishin “*të zinj dhe nuk dinin të gjithë të këndonin bukur*”

Poeti është ëndërrimtar i madh, por endet në botën e shqetësimeve, prandaj edhe realiteti dhe ëndrra dyzohen e përplasen, siç ngjet në vargjet e mëposhtme:

kur të zgjohemi nga kjo ëndërr e bukur fëmijët nuk kanë për të dëgjuar

përrallat tona të bukura që s’i kanë dy palë mend
së paku të injorojmë vetveten dhe t’i shuajmë gacat e kujtesës

Qortimi i ndërgjegjes

Poeti shkruan për temat themelore të artit, dashurinë, besnikërinë, frikën, njohjen, heronjtë, historinë, besimin, pesimizmin, marrinë, rregullin, dyshimin, gjykimin, magjinë, harresën, kujtimin, gjallimin, për detin, shkretirën, shegën, pëllumbin, fluturat, zogjtë, rrugët, fosilet, pallatet, barin, këngëtarin, tymtarët, fortesat, sendet, ngjyrat. Pastaj, poeti shkruan për këngët, poetika e së cilave është metafizika e jetës, që shoqërohet me lule, të cilat, ndonëse janë të bukura, prapëseprapë vdesin, siç vdesin njerëzit dhe bëhen kujtime. Ai shkruan edhe elegji, duke e zhvendosë këngën në disa rrafshe, si dhimbje e mungesë, si kotësi e kërkesë, duke qortuar ndërgjegjen: *në këtë natë pa ndërgjegje* (“*Marria*”)

Poezitë “*Vdekja e rrenës*” dhe “*Vdekja e së vërtetës*” shuhen për një tension të pazakontë poetik, një drithërim paradoksale, meqë poeti duket përmbi humnerën thotë:

*shteti duhet edhe më të rrojë
se njerëzit janë ende të këqij
edhe vdekja duhet të jetë
se njerëzit nuk mësuan ç’është jeta*

E gjithë kjo ndodh meqë e vërteta fashitet dhe rrena ngadhënjën, në një botë ku rruga nuk shërben për të udhëtuar dhe ku virtyt është marrëzia. Në poezinë e Berishajt *mbi detin jon çojnë dashuri dy shpirtra të këqij* dhe e bardha dhe e zeza shfaqin kontrastin dramatik emocional, në një botë ku nuk dihet nëse gomari ecë para njeriut apo e kundërta. Kurse te poezia “*Dramë kishtarë*” shenjt i do të bëhet djall e djalli njeri ose si te vargjet e mëposhtme:

*perëndeshë e bardhë
e veshur në të bardha
në zemrën time të zezë
të veshur në të zeza
për çdo ditë*

Në ciklin e poezive me tematike historike, bëjnë pjesë poezia “*Vranakonti*”, “*Shpërngulja e arbëreshëve më 1468*”, “*Donica Scanderbeghi*”, “*Engjëllorët*”, “*Rruga e Pjetër Engjëllit*”, “*Shpirti i Andreas*”, dhe përçojnë dramën ekzistenciale të kombit shqiptar dhe rrjedhimisht gjuhës shqipe. Në natën e gjatë pa ndërgjegje, poeti bën dialog me Donica Scanderbeghi dhe e kërkon

*ti ulu në këtë gur që përditë po e lindim
dhe thuaj a ishim apo nuk ishe kurrë*

Në poezinë “*Shpërngulja e arbëreshëve më 1468*”, poeti vajton ikjen në udhëtimin e pakthyeshem të arbëreshëve, të cilët për të shpëtuar eshtrat, ndërgjegjen, *secili shpirt shpëton nga një asht nga humbja*.

Kurse, te poezia e bukur “*Këngë e mërzitshme në rrugë*”, kemi një dyzim atipik të subjektit lirik dhe raportit me subjektin. Duke e përdorë figurën e aliteracionit, qenia lirike kërkon diçka më sublime se ç’mund të jetë gjëja më sublime, dashuria:

*sepse ai për to kërkon një fjalë më të bukur
se ç’është për shembull
dashuria*

Poezia e mirë të bën të jetosh me të, të vuash dhe të gëzohesh, të prekësh fundin e ferrit dhe të përzhitesh në zjarrin përcëllues të tij, e pastaj, i freskuar, të mundëson të shtegtosh nëpër purgator, drejt qiejve të parajsës, me udhërrëfyes poetin e urtë dhe dashurinë e singertë. Lexuesi i këtij libri do ta ndjen këtë dimension të poezisë përgjatë këtij udhëtimi imagjinar që fillon me librin e parë “*Shpirti*” dhe përfundon me librin e dhjetë, “*Këngë mbi këngët*”, cikël ky që mund të lexohet në raport me këngët biblike.

Stili dhe gjuha e kësaj poezie janë madhështore, përkundër faktit se autori shkruan për ankthin e vdekjes, shuarjes, humbjes, sepse matanë këtyre temave, ligjërimi i këtij libri kërkon fenomenologjinë e jetës që qëndron në thelbin e gjërave, për të cilat njerëzimi gjithmonë aspiro e në të cilën betejë arti kurrë nuk dorëzohet. Dhe, në botën e rrenave dhe marrive, të ankthit e ikjes, të injorancës dhe turmave, poeti nuk dorëzohet dhe kërkon pallatin e së vërtetës, përballë botës ku e vërteta vdes e ku u ngrihen përmendore marrive.

Për fund, dua të them se ky libër, poezisë shqipe ia shton shkëlqimin estetik dhe vjen si një *gosti e bukur poetike* për gjithë lexuesit e apasionuar që duan art të mirëfilltë.

(Ky tekst është botuar si pasthënie e librit me poezi “Fenomenologjia e vdekjes”)



Krilla e kujtimit tënd

cikël poetik nga

RUDOLF MARKU

POETËT

Poetët mbliidhen në Ferr,
Mes squfurit djegës. Bisedojnë të qetë
A thua se janë në shtëpinë e tyre.

Gjuha është një tunel i pafundm;
Bashktingllore basesh. Zanore prej flauti.
Por zhurmat në Ferr i mbysin bisedat e tyre.
Kush tha se do të donin t'i zhvendosnin yjet
Drejt Mëshires, drejt përdëllimit?

Poetët janë qytetarë të Ferrit,
I mbushin penat e tyre me squfur, me gjakun e vet,
Me ëndërrat e të panjohurëve, me rrëfime
fantazmash,
Të dënuar për shkak të tingujve, të ritmit, të fjalëve
Dëgjojnë bisedat sekrete të sferave qiellore.

Poetët janë qytetarë të Ferrit.
Ecin nëpër hone malesh, kundër gravitetit të
dashurisë
Për të arritë mëkatarët e braktisur nga gjuha.



KURRË NUK DO MBRIJ NË TIRANË

Shkapërcej male, lugina, hone të frikëshme,
I bie mespërmes Mesdheut, Adriatikut, Jonit,
Por nuk arrij në Tiranë,
Dhe jo e jo në Shqipëri.
Ne Heathrow, Gatwick, Stansted më qeshin,
Më thonë se nuk do shkosh asgjëkund,
As në Eldorado dhe as në Ferr,
E pastaj më thonë me takt, me kujdes,
Është më mirë të mos marr as avion e as tren

Sepse Trishtimi nuk qenka gjeografi,
Sepse Trishtimi nuk qenka Vend.

Zgjedh rruge të tjera. Me anije, tragete, nëndetëse,
Kaloj tunele sekrete të nëndheshme të mallit,
Përdor taktikat moderne të katapulteve të kujteses,
Teknologjinë më të fundit të shpejtësive të zemres;
Në Rinas më qeshin e pastaj më thonë
-E kupton dhe vetë, nuk ke mbërrit në Tiranë,
Dhe jo e jo në Shqipëri



Sepse Trishtimi nuk qënka Vend,
Sepse Trishtimi nuk qënka gjeografi.



PËR E. B.

Ti më thua se Poezia është një gur i lemuar
Që e marrim me vete pa u kujtuar kurrë.
Trishtimi është ulur në shkallët tona,
Me sytë e ftohtë na veshtron me këmbëngulje,
Trishtimi që nuk ka ku të shkojë, i përzënë nga të
gjithë.

Perpiqemi të jemi njerëzor. Ecim vertikalisht,
Flasim për qyteterimin, për galaksitë dhe librat
Me një sintaksë rrethore;
Dhe koha që përserit vetveten!
Sa vite kaluan që kur e thyem buken bashkë?
Që kur ëndërrat i vumë në ca diagrame
Për të arritë labirinthe me hyrje falas?

Në stinen pritëse të marr me vete,
Drejt Betlehemit. Pa një yllë orientues
Vetem me at' gurin e lëmuar që për pak e harrojmë.
Nisje nuk ka. Ka vetëm mbërritje.
Ti prek bashktingëlloret e dhëmbjes me gishtërinj
delikatë
Për të shkruar strofen aleksandrine të vetëvrasjes.

Pa e kuptuar kemi arritë Oqeanin Paqesor.
Qenka e lehtë të shohesh se si koha ngrihet
Nga dallgë të stërmëdha për t'u mbytur prapë !



INFERNO

Në Fleet Street njerëzit, autobuzët lëvizin ngadalë.

Orakulli i Delfit nuk munda ta parashikonte Londrën.

Zotat e mëvonshëm e ndëshkuan me zjarr dhe
murtajë.

Zotat e sotëm janë të depozituar në Bankat e City-t.

Shoh Portat e Ferrit që mbyllen ngadalë.
Në anën tjetër të Tamizit.



NATA E FUNDIT E OVIDIT NË ROMË

I përzënë, për t'mos u kthyer kurrë më në Romë,
Më flakin në cepin më të largët të Perandorisë,
Atje ku barbarët kërcënojnë nga ana tjetër e Lumit,
Në një gjuhë të pakuptueshme. Larg lexuesve të mi;

Të shkruash pa lexues është njësoj si të vallëzosh në
terr.

Është nata e fundit që jam në shoqërinë e Macerit,
Që flas me Propertius për Safon, Kalimakun, Katulin,
Që i rrëfej Virgjilit, Horacit dhe Tibullisit
Se Korina në të vertetë kurr nuk më ka dashur;
A nuk e pa Botën më qartë se askush Homeri i Verbër?

Eci përgjatë Tiberit;
Nuk kemi vdekë, sa kohë që jemi në ujnat e një Lumi,
Dhe jo veç në bregun e tij!
Ciceron i mençur. Edhe ti vdiqe nga shpata,
Larg bregut. Djabatas dhe Majtas gjithnjë sheh në
rreshta barbarët.

Romakët numërojnë fitimet. Ngrënje që nuk kanë
fund;
Dehjet dhe dollitë për Perandorin. Nuk kanë kohë të
lexojnë Poezi;
Senatorët i mbyllin veshët ndaj metrikës
aleksandrine, heksametrit
Të rrethuar me kurva, përçmojnë poezitë e dashurisë
Ndërsa gratë dhe vajzat e tyre ënëdrojnë në shtrat
poetët.

Nesër do nis udhëtimin për në vendin e Barbarëve,
Tani që Barbarët filluan të dynden në drejtim e
kundërt, drejt Qendres;
Sepse Barbarët e dinin prej kohësh:
Kur Roma i përze Poetët e vet
Është koha e duhur për t'i rënë Perandorisë!



NISJET

Ishte Verë. Udhëtonim me tren
Duke kaluar stacionet që i quajë Askund,
Koha kur shkruanim ëndërrat në një letër të
përbashkët,
Kur diagramet e ëndërave nuk premtinin një fund.

Në stacione pamë Ullisin që s'kish mbërrit në Itakë,
Dhe Penelopen e plakur që nuk priste askënd,
Trishtimi na tha të kërkonim një nisje tjetër,
Për t'mos patur kurrë mbërritje në një vend.

Udhëtojmë pa u ndalur mes labirintheve të Fatit,
Duke parë stacionet me emërin Askund ,
Në këtë Botë ku Ulisi kurr s'arrin në Itakë,
Në këtë Botë ku askush nuk shkon asgjëkund.



KRILLA E KUJTIMIT TËND

Krilla e kujtimit tënd fluturoi përzishëm,
Mbi mal t' Anakreontit ku ka rënë borë;
Por Lumi i Thamizit nuk premtin kurrëgjë,
Të paktën të ishe floqë me të prekë me dorë!

Vjeshta në Londër vjen me gjethe të mëdha që bien,
Dhe me patat e egëra që lënë Kopështin Kensington.
Krilla e kujtimit tënd fluturon në qiej përzishëm
Nuk e lënë të ulet as në Anakreont!

Ajo dhomë e çveshur që na njihte të dy,
Si shpirtëra të humbur në një botë mizore,
Kurrë nuk na sheh më . Me mijëra kilometra larg
Endemi si fantazmat e një botë rrënoje.

Ka vite q'u mësova të shoh lart, në qiejt,
Zogjtë shtegtarë që nisen ngadalë në fluturim
Me një krah të thyer krille fluturojnë fatet e dashnive
Si shpirtëra të përzënë që s'u lejohet kurrë më kthim.



VENDI IM

Emri yt ende nuk është shkruar ;
Vazhdon ngjitjen tënde në drejtimin e kundërt të gravitacionit të dashnise,
Në trajektoren e dhimbshme të Harreses.
E di se këtu kujtesa vret më tepër se Terrori
O Vendi im i braktisur nga gjuha.

Askush nuk na e thotë vendin ku jemi.

E prapë vazhdon të ngjitesh në malin mistik të teologjisë së dëshpërimit,
Me formula të frikëshme honesh. Derisa arrijmë në atë piken mes Qiellit dhe Tokës,

Në vendin më të bukur të Dheut. Jo shumë lart, por jo dhe aq poshtë,
Në qoshkun e preferuar të engjëjve.
Vetë Engjëlli i Historisë të ka zënë pritë,
Me plagët e përhershme- Masakrat e Fatit;

Engjëlli i Historisë që nuk na thotë as vendin se ku jemi
O Vendi im !



E PSE U DASHKA TË JEM NË KËTË QYTET

E pse u dashka të jem në këtë qytet
Ku zemra më dhëmb? Shiu bie si tridhjet’ vite më parë
Ngjesh me vitrinat njerëzit të mos lagen rrinë,
Si manekinë.

Si tridhjetë vite më parë pres të më shfaqesh
Nga një qoshe rruge që nuk ka kuptim
E lagur,bërë qull, si nga dënesjet e dikurshme
Në këtë qytet pa asnjë premtim.

E di që je larg, Kontinente larg
E di se shiu është i rrallë në Kaliforni,
Por unë vij nga Londra, dhe njerëzit më thonë
Se në këtëqytet unë vetë solla shi.

Pa e ditur se shiu ka filluar më parë
30 e ca vite bie, me rrebesh dhe furtunë,
30 vite që njerëzit nuk ngren sytë nga yjet
30 vite që njerëzit janë më të vetmuar se kurrë

E pse u dashka të jem në këtë qytet
Poshtë yjeve që s’i prek asnjë histori?
Trobaturët kanë vdekur, të gjithë kanë vdekur
E askush nuk kujtohet se lotët quhen shi.



KUR ANIJA E POETIT

Kur anija e Poetit të thyhet prej dallgëve,
Me dhogat, hartat, velat, që pluskojnë mbi det,
Ndërtoni varkat tuaja,

– O njerëz që qëndruat gjithë jetën në breg !



Cigaren e mbante plot hijeshi në dorën e hollë e bardhoshe. Ishte ulur në një kthinë të ndyrë si stallë derrash që qelbte erë. Kushdo që nuk e njihje mund të habitej me prezencën e asaj dame në atë ndyrësi. Por shumica e njihnin dhe e dinin që ajo ishte Frida, kurtizania e portit. Shtatlartë, afër të 30-ve, gruaja shpaloste një bukuri e nur të mahnitshëm. Trupin e saj të drejtë, gjinjtë e mbushur e të rrumbullakosur, buzët e plota, sytë e zinj, flokët e dendur e të gjatë, i plotësonte një veshje prej mbretëreshe.

Të gjithë në port e njihnin dhe e respektonin gruan. Ishte një grua që ofronte shërbimet e saj kundrejt pagesës dhe respektit. E veçanta e saj ishte se ndryshe nga kurtizanat e tjera që endeshin me marinarët, kapitenët e me raste të rralla edhe me ndonjë nga hamallët e portit, Frida numëronte vetëm dy burra. Njëri ishte marinari 29 vjeçar, Martini, tjetri ishte doktori i anijes "Rosabela" doktor Edmundi.

Jeta e Fridës si kurtizane e si grua ishte lidhur pazgjidhshmërisht me këta dy burra. Mirëpo fati kishte plane të tjera...

Një të diel tetori kur pritej të vinte në port "Rosabela" e bashkë me të dhe doktor Edmundi, erdhi lajmi se anija do të vonohej edhe disa javë. Frida që po priste në kthinën e përhershme mbërritjen e anijes dhe të të dashurit u ligështua. Tek po ngrihej për t'u kthyer në dhomën e saj në hyrje të lokalit u duk kapiten Gasperi. Pasi u përshëndetën ai e ftoi zonjën për një gotë. Dukej i sikletosur dhe nuk po lidhte mirë bisedën. Por pas gotës së dytë kapiteni u burrërua dhe lëshoi fjalët, që më në fund arriti ti lidhte.

- "Rosabela" vjen në darkë. Doktor i jo. Ka mbetur në një ishull. Vdiq aty. I sëmurë me ethe hemoragjike.

Kaq tha kapiten Gasperi. Frida kishte ngrirë me qëndrimin drejt dhe sytë ngulur tej në horizont. Kjo ndodhi para disa muajsh.

Kësaj here Frida po pret të dashurin tjetër, Martinin. Ndryshe nga doktori (ndjesë pastë), Martini është më i gjallë. I shkathët, bukurosh, plot jetë, ai e çon Fridën në dimensione të tjera. Luajnë të dy, dashurohen, qeshin, zihen shëtisin dhe netëve të dimrit kur ai ndodhet në tokë pijnë bashkë deri në dehje. Zbulojnë sekrete, komplete, ishuj të harruar, luajnë piratësh e zanash, gjejnë thesare nëpër shpella dhe zhyten në kaltërsinë e kënaqësive. Duket se janë bërë për njëri - tjetrin. Me Martinin, Frida e ndjen veten fëmijë. Fëmijë çapkën e lozonjar. Me doktorin ishte ndryshe. Tjetër sjellje, tjetër status.

Pikërisht atë po pret Frida tani, Martinin. Ajo e di përmendësh skenarin. Anija do ankorohet, marinarët do zbresin njëri pas tjetrit, ai do të zbrësë i parafundit. Do të hidhen në krahët e njëri-tjetrit.Martini do ta rrotullojë siç mund të rrotullojë babai vajzën e vogël. Ajo do të qeshë hareshëm. Do të rroken, puthen përqafohen dhe ashtu të ngjitur do të shkojnë jashtë portit për të drekuar bashkë. Nata do ti gjejë të zhytur tek njëri-tjetri duke marrë frymën e sho-shoqit. Dielli do të lindë me ta e për ta.

Këto mendon Frida ndërkohë që pret me padurim ardhjen e Martinit. Por Martini nuk duket se do të vijë. Po vonon.

Kapiten Gasperi përshëndet nga jashtë lokalit me kokë. Ajo ia kthen pa shumë entuziazëm. Dhe pret. Pret anijen që do sjellë Martinin. Koha kalon ngadalë. Dikush lajmëron se anija po vjen. Ja ku duket. Frida del jashtë në ajër të pastër dhe e paduruar bën ecejake.

Më në fund anija ankorohet dhe turma e njerëzve që presin në shesh mblidhet mizëri. Detarë në pension, kapitenë, marinarë, kurtizane, hamej, fëmijë që presin baballarët, gra për së mbari, të gjithë presin. Por ndryshe nga herët e tjera kur marinarët e sapombërritur dilyn pa radhë e plot zhurmë dhe kapiteni i anijes bënte sikur nuk vërente gjë, kësaj here marinarët janë rreshtuar në kuvertë dhe po nderojnë. Turma vëzhgon e heshtur. Diçka po ndodh. Një fëmijë dallon të atin në kuvertë dhe bën ti lëshojë dorën së ëmës për të vrapuar drejt tij por dora e hekurt e gruas e ndal në vend. Katër marinarë të fuqishëm dalin ngadalë nga pjesa e brendshme e anijes duke mbajtur në krah një arkëmort. Zemrat e turmës rrahin me një ritëm. Frida padashur ka shtrënguar kycin e dorës së kapiten Gasperit. Ky ndjen një fërgëllimë në të gjithë trupin. I afrohet më afër. Gruaja i ka ngulur sytë tek arkëmorti. Me shpejtësi kalon dhe njëherë në revistë gjithë rreshtin e marinarëve për të dalluar Martinin. Nuk e sheh askund. Ndoshta është brenda. Brenda ku? Jo, jo në arkëmort. Mbi kyçin e dorës së kapiten Gasperit janë ngulur thonjtë e Fridës. Burri ndjen dhembje por nuk e jep veten.

Kapiteni i anijes urdhëron të qëllohet me top për nder të marinarit Martin N. Emri i Martinit elektrizon trupin dhe mendjen e Fridës. Gruaja nuk dëgjon, nuk sheh më asgjë. Pas goditjes së tretë e të fundit me top, turma e përlotur i hap rrugën djemve që mbajnë trupin e të ndjerit në supe.

Një ditë më pas.

Frida ndodhet e shtrirë në dhomën e saj. Mbi krye i qëndron kapiten Gasperi dhe vajza 15 vjeçare që shërben vaktet në hotelin e kurtizaneve. Gruaja përmendet dhe menjëherë i vjen ndërmend i dashuri i vdekur. Pyet kapitenin për të.

Edhe kësaj here i takon kapiten Gasperit t'i njoftojë detajet e vdekjes. Martini u qëllua aksidentalisht në anije. Një grindje mes shokësh. Punë bixhozi. Djemtë ishin ca të dehur, po luanin dhe njëri bënte hile. Nisi sherri, grushtat dhe grindja degradoi deri në rrahje masive. Martini u ndodh aty dhe u fut mes tyre për të shuar sherrin mirëpo një prej djemve, më i dehuri mes tyre rrëmbeu një levë dhe e goditi Martinin në kokë. Vdiq në vend. Sigurisht që vrasësi do ta paguajë, do të dalë para gjyqit. Kështu i tha kapiten Gasperi. Frida përpiu çdo fjalë të rrëfimit dhe në fund zhyti kokën në jastëk e u shkreh në dënesa.

Pasi u qetësua ca u kërkoi dy shoqëruesve që ta linin të pushonte. Kishte nevojë të pushonte.

Gjithë ditën ajo nuk doli nga dhoma, nuk u pa gjëkund. Në mbrëmje vajza e vogël u ngjit në dhomën e kurtizanes për t'i çuar darkën. Dera ishte e mbyllur dhe vajza zbriti sërish shkallët. Të nesërmen paradite kapiten Gasperi u ngjit në dhomën e Fridës. Një natë më parë kishte menduar për të dhe për faktin që tani ai mund të kishte ndonjë mundësi me të. Ndoshta tani që mbeti pa asnjë nga të dashurit e saj vetmia dhe mungesa e parave do e hidhte gruan në krahët e tij. Kishte shpresë kapiteni. Trokiti. Asnjë përgjigje. Trokiti sërish.Sërish asgjë. Atëherë mori vrull dhe iu sul derës duke e hedhur përtokë.

Dhoma kutërbonte erë vdekje. Frida dergjej mbi shtrat me thikën e ngulur drejt e në zemër. Kapiten Gasperi lëshoi një psherëtimë. Nuk kishte më shpresë.

Kënga e këngëve

tregim nga

ARB ELO

Eda ka qenë lexuesja ime e parë, por ajo nuk e dinte ose nuk donte t(i)a dinte se shkruesi i mesazheve isha unë. Një herë më doli nga mendja të ndërroj profilet e ia dërgova vjershën e radhës me emrin tim të vërtetë, mirëpo ajo kujtoi se po i luaja ndonjë rreng e më qeshi në fund të një mesazhi, - më dërgoi një smiley - pasi më kishte shkruar: “Jo keq, por duhet të punosh goxha për të arritur hijeshinë e stilit të murgut...”

Pasi Eda besonte se mesazhet ia dërgonte një murg nga Mali Athos - që banonte fillimisht në Ardenicë, të cilin m'u desh pasta ta transferoja në një vend ku nuk lejohen gratë, kur Edës iu ngrit mendja të shkonte e ta takonte në manastir.

Kishim qenë bashkë në të njëjtin kurs gjuhe dhe të njohur të zakonshëm, gjer ditën kur një shoku ynë i përbashkët pati hapur asokohe njëfarë pijetoreje për artistë të rinj - apo pijetore për të rinj që donin të bëheshin ose u dukej vetja artistë; vështirë të sqarohej kjo - dhe ndodhi që haseshim thuajse çdo mbrëmje dhe aty vura re se ndieja edhe më shumë se kaq për të, ngase nisa ta mendoja edhe në kohën që s'gjendej atypari, mirëpo shoqëria që kishim derimë atëherë me njëri-tjetrin e që kësaj u forcua edhe më, jo vetëm nuk më ndihte t'ia shprehja këtë tërheqje, por edhe po më pengonte, pasi Eda nisi më trajtonte gjithnjë e më shumë si mik të ngushtë, dhe çdo përçapje për diçka më shumë se aq, qoftë edhe në të menduar, nisi të më dukej si abuzim me mirëbesimin e saj.

Ndaj mbase mora një herë të shkruaja çka duhej t'ia kisha thënë përndryshe gojarisht dhe ia dërgova si mesazh në Facebook nga një i panjohur, i cili nuk merrej vesh pse i shkruante, gjë që m'u duk fillimisht si ndërmarje e pashpresë, e cila ose do të injorohej nga ajo në rastin më të mirë, ose do të merrte ndonjë sharje të hidhur si përgjigje, në rastin më të keq, dhe Eda s'ta përtonte edhe për fjalë të ndyra, kur e donte puna.

Sidoqoftë kjo paskësh qenë për mua, me sa dukej, alibia më e mirë për të shkruar lirisht dhe, meqenëse bëhej fjalë për diçka të pafajshme e të dëlirë, sipas meje gjithnjë, nuk i vuaja as brerjet e zakonshme të dyzimit të ndërgjegjes në raste të tilla, - aq më tepër që mesazhet e mia qenë jopersonale e të mirësjellshme; në më të shumtën e tyre lirike - në mos poezi që përshkruanin gjendjen time shpirtërore atëbotë, nga autorë të njohur, apo edhe të shkruara vetë më vonë, kur Eda nisi të më përgjigjej, aspak me egërsi, siç e kisha menduar në drojën time, por thjesht e me dashamirësi, si ç'bëjnë pothuaj gjithmonë vajzat për të qenë, kur u drejttohesh butë dhe njerëzisht, gjë të cilën unë e kam mësuar, për fat të keq, kaq vonë.

Fillimisht i pata dërguar një fragment nga »Kënga e këngëve« të Biblës, të cilit ajo, besimtare e lëkundur ato vite, ia kishte krahasuar gegnishten

e përkthimit me atë në anglisht, për t'u bërë pastaj kureshtare për dërguesin e për t'i kthyer këtij përgjigje, mua domethënë, teksa më pyeste njëkohësisht se kush isha.

Për një trill të çastit, e përfytyrova këtë si murg që ka hequr dorë nga epshet, për t'iu dorëzuar megjithatë dashurisë hyjnore të patrup, qoftë kjo edhe e gjinisë tjetër.

Një rishtar në Manastirin e Ardenicës, që merrte e jepte me botën me anë të internetit, - histori kjo, që po të shqyrtohej mirë, linte me siguri goxha për të dyshuar, - mirëpo ja që kjo s'ndodhi me Edën, të cilës mbase, më shumë se të dyshonte, i vinte për mbarë të besonte, gjë që, kur e kam menduar më me ngë, kishte shumë të ngjarë ta kisha bërë unë vetë më së pari, duke mbyllur me dëshirë jo vetëm njërin sy, por të dy të mundshmit, ndoshta ngase shumëkujt - përfshirë këtu natyrisht edhe pakësinë time - i pëlqen të besojë që një i/e panjohur diku në botë e dëshiron vetëm për atë çka është vërtet, domethënë për shpirtin/fjalën e tij/saj dhe jo atë që duket, kupto: trupin, pamjen, a gjësende të tilla të përkohshme.

Marrëdhënia jonë e dytë paralele - efemere, si të thuash zuri fill pra si rastësisht relativisht lehtë, me një profil të rremë murgu. Edhe vetë e vija re se ndryshoja disi së brendshmi, kur shkëputesha prej profilit tim, atij të përditshmit, normalit, për t'u lajmëruar prej tjetrit, atij anormalit, hyjnorit, qiellorit, prej të cilit i dërgoheshin asaj vargjet më të ndjera për dashurinë e më gjerë të kinse poetëve më të njohur e më të panjohur botërorë e shqiptarë.

Këtë ndryshim nisa ta vija re pas duzinës së parë

të mesazheve edhe tek Eda, kur gjendesha aty pranë dhe asaj i vinte mesazhi i radhës, gjithnjë e më dendur përgjatë kohës kur priste që t'i vinte tjetri, ndryshim që, nga ana tjetër ma përforconte mua nxitjen për t'i shkruar më shpesh, deri në një pikë vlimi, gjersa ana tjetër jona, (ajo e përmalluara, eterikja, absolutja sipas Platonit) nisi të dominonte tokësoren, rutinën e punëve e hallevë të përditshme e të na bënte më ëndërrimtarë, më të ndjeshëm, fundja më të bukur: të paktën kështu më ngjan kur e kujtoj nga pas atë kohë, që erdh' e u bë kështu ndër më të bukurat e jetës sime.

Kështu e vlerësoj tani që po shkruaj këto radhë, se asokohe nuk isha i ndërgjegjshëm për këtë, i humbur ashtu në metatekstin e identitetit tim, që ia kisha falur bujarisht një tjetri, - ndonëse në marrëdhëniet tona të përmbrëmshme s'kishte ndryshuar asgjë, po të heqim këtu përqafimet disi më kapërthyes e ca më të fikëta kur piqeshim dhe ndaheshim me njëri-tjetrin.

Për të qenë edhe vetë dëshmitar i dehjes që shkaktonin tek Eda mesazhet e murgut, që tanimë kishin kapur përmasat e letrave, nisa ta ruaja çastin e dërgimit për kohën kur qemë bashkë: ia nisja ato nga celulari disa minuta pasi qemë takuar dhe përjetoja jo pa ego letrare përndezjen e lëkurës së saj që kuqërremej lehtë, fryrjen e lehtë të buzëve dhe kafshimin e tyre nën vetëdije nga dhëmbët e parë, të cilët e shfaqnin hapur padurimin para se t'i merrte dhe kënaqësinë kur i merrte vërtet.


Kjo më ngazëllente deri aty sa të gjeja një sebeb për t'u larguar ca prej aty që të shkruaja lirisht a për t'u mbyllur në tualet, vetëm e vetëm për t'i hartuar një tjetër syresh, që i binte të ish edhe më i zjarhtë, edhe më cerebral se i pari, porse, në të vërtetë, duke i shkruar Edës, unë po shkruaja poezi të mirëfilltë, me aq sa mundesha, natyrisht, poezi që i drejtohej femrës ideale, Sulamithit, Beatrices, Margaritës, Tanushës sime në këtë botë, rolin e të cilave e luante për mua Eda, jo Eda tokësore dhe mikesha ime, por marrësja e kumtit, abstraksioni i saj, kuqëlma mbi mollëzat pra e jo mollëzat vetë.

Edhe për këtë u kthjellova shumë më vonë, kur vjershat që i pata dërguar erdhën e morën gati vetiu përmasat e një vëllimi të mundshëm me lirika. Eda m'i tregonte edhe mua mesazhet që merrte e shpesh edhe m'i komentonte e mua më dukej pastaj se ishte vërtet

një tjetër ai që ia kish nisur, ndonëse koha mes shkrimit prej meje dhe marrjes së tyre nga ajo ish e atypëratyshme. Shpesh kam patur ndjesinë se ajo, ashtu siç edhe unë vetë, megjithëse e merrte me mend se mesazhet i vinin nga unë, në mos e dinte këtë me siguri, parapëlqente të besonte se shkruesi ishte tjetërkush dhe, duke qenë se kjo më ndodhte edhe vetë, s'do të më kishte habitur fare po të kishte qenë vërtet ashtu, siç nuk më dridhej qerpiku dhe nuk e tradhëtoja asfare veten kur ajo më lexonte vjershën e radhës e harroja ndërkaq që atë e kisha shkruar unë, deri aty sa edhe të prekesha prej saj.

Një natë, pasi ia pata ruajtur gati me sadizëm dozën e dy-tri ditëve pa ia dhënë, një vjershërim të gjatë, i cili ato ditë më ngjante goxha i kulluar, e bëra atë gati në celular në xhep veç për të shtypur »dërgo« dhe prita rastin kur lamë lokalën dhe po ktheheshim për në shtëpi.

Ajo kishte qenë gjithë mbrëmjen disi munguese dhe e hutuar në bashkëbisedim, të cilin e kishte ndërprerë shpesh pasjellshëm për të parë për të satën herë celularin, i cili tringëlli zbehtë kur erdhi mesazhi, krahasuar kjo me klithmën e saj kur pa dërguesin.



Ndaloi atëherë, u ul në anë të trotuarit, u ula edhe unë në krah të saj e këndja e saj ish edhe këndja ime; heshti, pasi mori frymë thellë kur mbaroi së lexuari, m'u kthye papritur si të ish një tjetër dhe m'u lut pastaj befas ta merrja në krahë e ta puthja.

Mbylla sytë dhe bëra ç'më tha dhe, ndërsa po humbja në errësirën e ngrohtë e të thellë të buzëve të saj, më shfaqej në t'errëtin e kapakëve të syve të mi nga brenda koka e Deas, e përshoqëruar me tekst, me rreshta nga të parët që i kisha dërguar asaj:

*N'shtrojen teme, natën, kam kërkuar të dashtunën e zemrës s'eme:
e kam kërkuar, por gjetë s'e kam.
Kam me u çue, kam me iu sjellë qytetit; nëpër rrugë e sheshe; due me e gjetë të dashtunën e zemrës seme.
E kam lypë gjithkrah, por s'e kam gjetë.
Më gjetën rojat...*

Kur po putheshim me Edën pata papritur ndjesinë që ai që po puthte nuk ish ai që e meritonte këtë, ndaj u tërhoqa prej saj ngadalë, duke ia rrëshqitur buzët prej buzëve në qafë e më tej në faqe, për të përfunduar në ballë, gjë që atë e bëri të vinte përhumbur buzën në gaz, a thua se e priste këtë, se po priste të shugurohej ashtu nga vetja ime e dytë, që tanimë kishte zënë vendin e së parës, nga vëllam Thoma Andoni, murg solemn në vetminë e tij lirike, që tjetrin/tjetrën e donte, në mos më shumë se veten e tij, të paktën po aq sa atë vetë.

Ndërsa ajo, vetja pra që po i linte vendin, po largohej disa buzë më tutje tok me tundimin, bashkë me Edën që tashmë ishte Afërdita - ndoshta edhe djalli vetë, por këtu u nguta t'ia pres fillin mendimit - e kjo më bëri të ngrija kokën për të kërkuar në qiell simotrën yllësore me të njëjtin emër.

Kur e gjeta, ashtu të vogël e të jermët në zbardhëllimin e saj, pak më t'afërt e më të skuqur se drita e ftohtë e yjeve të tjerë, m'u bë e qartë se nuk e kisha synuar asnjëherë vërtet as Edën, vajzën e dashur të kursit, me të cilën qemë bërë miq, e as femrën në të, porse diçka më të fshehtë e më supreme se aq, diç' që s'e kish të nevojshme të duhej nga unë, por unë nga ajo, duart m'u ftohën e bëra t'i fus nën zhgun, porse gjeta veç xhaketen time laike, ngase duart qenë ende të miat e gjendesha akoma në Tiranë, diku nga Komuna e Parisit, e jo medoemos në malin Athos.

Ne u ndamë pastaj si zakonisht, përqafimi që më i fiktë se kurrë dhe, ndërkohë që këmbët po më çonin drejt banesës sime, u bëra sërish e dalëngadalë ai i zakonshmi, i cili u pendua keq kur masturboi në banjo, me imazhin e Edës natyrisht, për rastin e çuar dëm. Menjëherë pas zbrazjes po ai u ndie po ashtu i vërtetuar në të mosbërit po ashtu asgjë në të vërtetë me të, saqë u ul e shkroi ca vargje për takimin tjetër.

Ishte tjetër orgazmë kjo e të shkruarit, më e gjatë e më qëndrueshme dhe sidoqoftë, - për këtë shkrova atë natë - do të kishte qenë përnjëmend humbje, nëse do ta kisha shkëmbyer atë tantra verbale me erotikën kohëshkurtër e bumerangeske të një marrëdhënieje të supozuar normale, të njëres nga ato marrëdhënie që i ndodhin përditë shumëkujt, të cilat gjeihen a të gjejnë pa shumë mundim pothuaj kudo.

Ndërsa ardhja e pafund e asaj që nuk vinte asnjëherë e tëra dhe asnjëherë kulmore ishte diçka pa barazvlerë, madje - edhe këtë ia shkrova atë natë për të nesërmen Edës - ndodhte pikërisht kur shkëmbimi ishte *a priori* i përjashtuar, pasi marrësi isha veç unë vetë e ajo/ai që më donte vërtet vetëm dhuronte e prandaj njeriut që e kërkon atë i duhet të lerë njërën për të marrë tjetrën, të heqë dorë nga femra, familja e fëmijët, për t'u dashur së fundmi si ç'duhet.

Mirëpo ky argumentim nuk është se e bindi as vetë shkruesin e tij, vëlla Thoma Andonin, që u shtri fill paskëtaj për të fjetur, pasi pati hedhur sytë së pari nga dritarja jashtë e sipër, që mbushur aty me frymë dhe pati mërmëritur si me vete një *Ati ynë në qiej...*

Shi i butë kurmesh

cikël poetik nga

ANDI MEÇAJ

BUBULLON E NDRIN NJË E QESHUR VAJZE

Rrotullohen gjethet, flokët
endacakët,
qëmtuesit e hedhurinave.
Hëna zhgarravit muret e natës
me spray portokalli.
Një e qeshur vajze bubulloi,
rrufe hareje.
Poet Rushitin
e kanë braktisur poezitë,
nuk i ushqen dot.

Goni, la në bast
bukën e fëmijëve dhe gjumin.
një i çmendur bërtet:
-Poshtë komunizmi!
Dy adoleshentë grinden
apo bëjnë sikur zihen,
ngrohin muskujt.

Rrotullohen gjethet, flokët,
endacakët që ikën duke mërmëritur,
as sot nuk kanë me se të ngopen,
ngopen duke parë hënën
që zhgarravit muret e natës,
natës që bubullon,
vetëtin e ndrin
nga një e qeshur
vajze.

Janar, 2019

SHTËPIA KA FTOHTË

Shtëpia ka ftohtë, mbërdhi,
mbërdhijnë dhe zërat
strukur qosheve.
Fotografia në mur,
diell që qesh.
Hapat e ngadalte
mezi ndihen,
kolla këndon
melodi të harruara.
Një kujtim
ardhur nga larg,
derdh grimca lumturie.

Era shkulmon kanatat,
sjell gu-gu foshnjash,
përkëdhelje dhe cicërima
që ngrohin shpirtin,
shpirtin e shtëpisë
që mbërdhi.

Shkurt, 2019

SHI I BUTË KURMESH

Mbi çati shfaqen njerëz të kuq
si njolla gjaku,
fillon të bjerë
një shi i butë trupash.
Trupash që mbushin
gropat e rrugëve.
Rrugëve që u kërcasin brinjët

nga dëshpërimi i mishit.

Mbi tarracë duken njerëz blu
si copëza deti,
fryn një erë e qetë
kurmesh.
Kurme që trazojnë
gjumin e qytetit.
Qytetit që prishet e ndërton,
ndërton e prishet
nga sipërorët e babëzitur.

Mbi ballkone shihen
njerëz të argjendtë,
si guguftu që puthen,
nis një rrapëllimë e ëmbël flatrash,
flatrash për të tjera botë,
flatrash për të tjerë qiej.

Shkurt, 2019

BRENDA NESH U NGUJUA FËMIJËRIA

Hodhi mbi supe
pallton e një nate të trishtë,
zboi ëndrrat,
u zhyt në kujtime.

Peshku i vogël, i kuq
e guduliste në gushë,
macja e mirë
dhe llafazane
dërdëlliste fjalë pakuptim.
Ai shkrihej,
qeshnin dhe pantallonat e shkurtra
grirë nga fërkimet.
Rrokullisej në bar
bashkë me pemët, retë,
kur topi thyente ndonjë xham
ose qelqurinat e diellit.

Papritur u shfaq ajo
anija e kaltër,
i rrëmbëu të gjitha,
shtëpitë e ngrohta të fëmijërisë
me prindërit e ëmbël
e pak grindavecë,
lulishten me zogjtë këngëtarë
e të dashuruar,
rrugicën ku loznim futboll
sikur bënim luftë.
Dhe xhaxha Pjetrin,
atë xhaxha Pjetrin shtrembanik
që na i shponte topat
sa herë i bombardonim
qeramidhet e çatisë.

Por ne vazhdonim,
vazhdonim të qeshnim, të bërtisnim,
të luanim, të ngacmoheshim,
pa e çarë kokën
se ashtu pa kuptuar
brenda nesh
u ngujua fëmijëria.

Janar, 2019



FYTYRA NË TURMË

Nga Sophia Maria Popovska

LIBRI I

FYTYRA QË FSHEHIN MELANKOLINË

Në Turmë

Floku im ka erën
e një shtëpie të çuditshme.
Zhgualli i kalldrëmit
i larë me një shi të ftohtë
që kundërmon kripë dhe asfalt
në një turmë njerëzish,
mendja ime i thërret vetes.
nuk vjen asnjë përgjigje,
e ardhmja nuk mban
ndonjë parandjenjë të jetës.



Iki Larg, Pavarësisht Vetes

Është një kohë kur iki larg, pavarësisht vetes,
e gjitha çfarë dhemb, pjesa më e madhe e trupit në
fakt, qërohet,
shkrin si një lëngësirë kryeneçe, e ngjitshme,
si mishi i bluar i suxhukut
dhe qëndron pas meje- një pellg gjërash që s'e kisha
menduar ta lija të ikte
por unë e bëra
dhe ende iki tutje.

Për pak kohë, nuk do të mbetem asgjë veçse kockë
e zhveshur,
dhe do të më dhembë fort kur të fryjë era mbi të,
çdo prekje e saj do të ndjehet si gozhdat që kruajnë
asfaltin e ashpër.
Pastaj imagjinoj, dejtë e trupit do të mbushen,
muskujt, lëkura dhe flokët.
E di, kjo është e vërtetë
por nuk e besoj në këtë moment, ende vazhdoj të
iki tutje.

Lë cdo gjë pas krahëve që ende e vret mendjen
përse gjërat e mira bëhen të këqija,
dhe nëse mund të shpëtohet diçka që ishte e dëlirë
fillimisht
e lë atë prapa sepse e di
që kjo do ta rrisë edhe më shumë naivitetin tim
mbi këtë skelet që di veçse të largohet prej vetes.

Tymërat e qytetit rriten romantikisht drejt qiellit të
natës
Yjet blu sipër meje dhe yjet e verdha prej letre në mes
ku e shoh se parandiej
amnezinë e këndshme në të cilën do ta hedh veten
në të ardhmen e afërt.

Është vetëm një nga ato net,
por është tashmë duke u zbehur kur mëngjesi po
shfaqet në horizont.

Mirupafshim

Çajniku fshkëllen
në heshtjen
e ftohtë
Avulli do të ngrihet
mbi buzë
të filxhanit.
Tej dritares
bota kthehet
qëndrueshëm.
Në anën tjetër
shiu bie
rrëmbyeshëm.
Frymëmarrja jote ngadalësohet
dhe fjalët që thua
janë shumë të buta.
Të mbledhurat e mesit të natës
mund të dëgjohen
në kollën tënde.
E ndiej lotin
që të mblidhet në qoshe
të syrit. Ti thua se
britma e kishte lëshuar
apo mbase unë
harrova.
Por dielli shkëlqen.
Jeta po kthehet
jashtë.
Dhoma qëndron në heshtje
Nuk i përgjigjet
botës.
Fryma ime është e cekët,
duke u përdredhur
në kordë.
Një pranverë kaq e mrekullueshme,
një çelje dite pranvere
me shi.
Lagështi në irisët e tu.
Përse?
Ky është pikërisht fundi i një bisede,
një fund në miniaturë,
mikroskopik,
por di që e thatë vetë e para.



Muzg

Errësira dyndet në dritaren time
si një bishë e padurueshme.
Një moment më prek në zemër
me sëmbimin e vetmisë
megjithëse duke u zhdukur me nxitim
nuk lë prapa veçse shijen e vet.

Mbrëmje të tilla nuk ishin menduar për lotë,
industrialë, të pluhurosur, gri të hirtë,
kështu që mbetem nga jashtë e paprekur.

Së shpejti do t'i fik dritat,
ta vë këtë mbrëmje në gjumë.

Një gjysmëhënë e vetmuar verdhoshe brendshëm në
qiellin pa yje
rrethuar nga një aurë ngjyrë hematome.

“Më merr me vete”

Ankth

Ka netë kur kam frikë se
realiteti është një fije rrjete merimange
që do të prishet,
fundet e tij të ngjitshme, të dala, të shpështillen,
duke zbuluar një pafundësi njëtrajtësie uniforme-
një akullnajë gjumashe,
një kuti të zezë.
Ka netë kur druham se
mund të arrij dhe të zhvesh
ngjyrën e llakuar të makinave, vezullimin në errësirë
asfaltin e mbështjellë në shkëlqimin e semaforëve si
dyllë i verdhë,
fytyrat e qeshura të të dashuruarve, të të dehurve
në mesnatë,
Çdo gjë është e zezë përbrenda,
pa kuptim,
pa fund.
Ajo e gjitha thërmohet dhe zhvoshket, duke u tretur
në një shkullm ere
dhe unë kam mbetur pezull në një qiell nate,
në hijet kapsallitëse të yjeve prej kohe të shkuar,
në shkretëtirën e pazëshme
pa asgjë vecse mirazhe-zambakë uji për të ngrënë,
duke vlarë kohën në një përjetësi të mpirë.
Ka netë kur rrethimet e larta miope, të pista dhe
portat me hekura të magazinave,
kur letrat e neonit mbi dyqane dhe kërcitja e këmbëve
mbi trotuar
më rrethon, më përdridhet rreth qafës,
më shtyp në zgavrat e syve,
inatosem që ato shfaqen të tejdukshme para syve
të mi-
vizione në një dhomë boshe,
dhe unë s'mund të marr frymë.



Jo Stuhia më e Keqe

Ja ku jam përsëri, duke shkruar poezi për të moshuarit
ku trazimit të brendshëm i qasesh me një ironi të
butë dhe të sflitur,
një gjendje që ndjehet si shfryrje psikologjike.
Kapërcej vijat e fillimit, e zhgënjyer,
Nuk dua ta filloj ndjesinë në këtë mënyrë, jo akoma.
Nuk dua ta topis agoninë, nuk dua burgim në paqë.

Ende, do të ketë shumë më tepër rendje përpara
mpirjes së fundit,
mendoj, qetësia e frikshme tashmë është duke u
vendosur.
Kjo nuk është stuhia më e keqe.



Një Garë për Askënd

Vetmia fillon kur jam pa veten.
Fjala lumë më është bërë një koleksion vogëlsish,
njëra mbi tjetrën, një zbrazëti e dhimbshme,
por gjithashtu secila një pilulë gjumi.
Fundosem më thellë në një dremitje të ngrohtë, të
pashqitshme-
një ëndërr që dhemb, ëndrra e një njeriu të mbytur.
Nuk mund ta kujtoj herën e fundit kur kam thënë
diçka kuptimplote
Dhe vetja ime e së kaluarës që ka thënë fjalë që
rezonojnë,
fjalë, jo tinguj, provokime vibrante të kësaj mpirjeje
gjithnjë të pranishme.
Gjuetari më i durueshëm
Ai person duket i çuditshëm

Një i çuditshëm që e kam zili më shumë sesa
çdo kundërshtar, më tepër se çdo njeri

që kam pasur lakmi ndonjëherë.
E kuptoj në retrospektivë
që jeta nuk është asnjëherë e sigurtë,

që mpirja nuk na lë asnjëherë,
asnjë dritë e shpirtit nuk është aq e fortë
mjaftueshëm sa për të pastruar rrugën,
dicka të shtyn prapa vazhdimisht-
dhe rregulli i lojës nuk është të
humbësh vitalitetin e shpirtit
në një jetë që e zbraz shpirtin përmes lodhjes së
trupit
dhe prët shpirtërimin
ndërsa shpërblen burokracinë.

Një garë që nuk është për të lodhurit-
një garë që nuk është për çdo njeri, vërtet.
Përfytyroj duke shtyrë tutje fundin e lumit,
duke u shfaqur edhe njëherë mbi
valët e mondanitetit
apo mbase jam ende brenda ëndrrës,

dhe mbytjes?



LIBRI II.
FYTYRA QË I QESHIN VETVETES

Një Lumturi e Vogël

Një lumturi e vogël
ashtu si drita e diellit që erëmon,
si hija e një dege që lëkundet në zhegun e rrugës së
mesditës,
si fryma e erës së malit që sjell shpirtin e luleve të
egra në ballkon.

Një vezullim kënaqësie.
Një thërmijë që ka gjithçka prej meje
ndërsa zgjat.

E di, kjo është lumturia e vërtetë
sepse nuk më duhet të mendoj për të.

Shikoj lart në blunë e shpuar të qiellit të pranverës
dhe vras mendjen nëse do t'i mbushet mendja

të më vizitojë përsëri, shpejt.

Të Jetosh

Me çdo fibër të zemrës,
me çdo qelizë,
dua të jetoj.

Në brengën e dhimbjes
që ma çan njërën gjymtyrë nga tjetra,
dua të jetoj

Dua të jetoj
kur të gjitha gjërat e mira ikin
madje edhe në kohët më të errëta.

Dua të jetoj,
dhe ushqej besimin
se çdo kthesë e jetës zhbën një dremitje të fortë.

Epshi im për jetën është një dhimbje e përjetshme,
një gjakim monumental dhe i pamatshëm
dua të jetoj përmes të gjitha gabimeve që mund të
bëj
përmes të gjitha dhimbjeve për të cilat s’kam
mbrojtje.

Vetëm të gjallët mund ta shijojnë dashurinë,
megjithëse e përgjithshme, kjo është parësore,
është një kusht që s’dua të dal mbi të
sepse vetëm dashuria është si fryma hyjnore.



Ditë Vere

Retë lëshojnë hije mbi rrëzën e malit
duke rendur të zëna rrugës së tyre.
Jeshil, bojëkafe dhe e verdhë është kjo rrëzë mali
duke bërë banjë në ditën e verës.

E ngrohtë dhe erëmirë me barërat e lëndinës
është puhiza e butë që lëviz retë e çrregullta
Bletët marrin nektar nga kokat e luleve pa u ndier
të cilat gjëlojnë gjithandej në fushën e pambjellë.

Vetëtin nga ngjyrat kjo ditë vere
duke shkrirë qiellin me pemën, tingullin me aromën
asgjë veçse eufori është kjo shfaqje e ndritshme
ku kënga e zogut plot gëzim kumbon pa u lodhur.

Transformim

Pranvera ka kërcyer
jashtë lëvores së saj
nga mëngjeset e mekura, të mjegullta.

Një ajër i ndryshëm del nga plasaritjet
brenda zbrazëtisë gri të hutuar
të një hëne dimri.

Ndjesia e diçkaje që mungon
që dhemb, një lloj mungese e pazgjidhshme,
ka shkuar tani.

Ndërsa lëngjet fillojnë të rrjedhin në degë
dhe erërat e ngrohta, të ëmbla fryjnë rrugëve,

unë harroj.
Një farë harrese engjëllore e velit të mjegullt të
pasdites.



LIBRI III.
FYTYRA QË RRINË NË MENDIME

Nature-Morte

Ai dekoroi trupin e tij të zakonshëm
me një fasadë të prerë intelektual
kur nuk kishte asgjë për të thënë.
Ai dekoroi heshtjen e mërzitshme
me një ajër meditimi filozofik.
Mund t’i dëgjonit levat e marrsheve
në trurin e tij duke punuar
me kujdes, duke sajuar dhimbshëm
çdo fjalë
Por në kohën që fjalët arrinin buzët e tij
ato tashmë ishin të ngrira.
Kurrë nuk kam qëndruar gjatë para pikturave
të llojit nature-morte (natyrë e vdekur)
Ato mund të jenë vërtet të bukura
dhe mund të kenë kuptime të pashprehura
por si mund të jetë interesante diçka
që është tashmë e vdekur?

Përkthyer nga Kujtim Morina



Sophia Maria Popovska është lindur më 8 dhjetor 1999, në qytetin e Shkupit. Studion letërsinë botërore në Georg-August-Universität, në Göttingen, Gjermani.

Vëllimin e parë poetik *Rewind My Mind: 50 poems*, e ka botuar në gjuhën angleze, në vitin 2017. Për këtë vëllim, Ferid Muhić, Presidenti i Akademisë Boshnjake të Shkencave dhe Arteve është shprehur kështu: “Në 50 poezitë që përbëjnë këtë vëllim, është ajo që shfaqet në sipërfaqe, ajo që shndërrohet në tinguj, në fjalë, në tablo, në emocione, në mirakandje, në gjendje shpirtërore. Dhe janë kaq mahnitëse, mbresëlënëse dhe intensive, sa të lejojnë të shohësh atë, çfarë është më e çmuar dhe më e bukur-në fund të fundit, ajo çfarë është më njerëzore!- të kuptosh se çfarë fshihet thellë zemrave tona, duke e shndërruar përmbledhjen *Rewind My Mind: 50 poems* të Sophia Popovskës në një festë të paharrueshme poetike, në një *Fiesta fabulosa poetica* të vërtetë”.

Vitin e ardhshëm, më 2021, del në dritë përmbledhja tjetër në gjuhën angleze *Faces in the crowd*, nga e cila kemi zgjedhur disa poezi për lexuesit e ExLibris.



Proust, Nabokov, Gogol dhe dorëshkrimet e djegura

Pse disa shkrimtarë i djegin veprat e tyre?

nga Alex George

Ka një arsye pse shkrimtarja e njohur amerikane Louisa May Alcott rrëfen se si personazhi i saj djeg dorëshkrimin e vetëm të së motrës, Xhosë. Amy mund t'i kishte grisur dhe bërë fërtele faqet e shkruara të së motrës, ose thjesht t'i kishte flakur në kosh, por nuk do të ishte njësoj. Ime shoqe më thotë që jam rrëqethur në kinema gjatë skenës së djegies së dorëshkrimit teksa po shihnim filmin e mbështetur në romanin *Gratë e vogla*. Asgjësimi thelbësor i shkatërrimit nga zjarri është kaq absolut, dhe për mua ky është tmerri. Nëse të shkruarit është veprim i ngadalshëm, i qetë, punë krijuese, djegia e faqeve të shkruara ndodh shpejt, dhe është plotësisht shkatërrimtar. Aty ku më parë kishte diçka, më pas nuk ka asgjë. Ka diçka tejet dramatike në aktin e vënies së flakës në cepin e një letre të shkruar dhe kundrimi i letrës që zhduket në gjuhët e flakës. Dhe ndërsa fjalët e fshira në një ekran kompjuteri zakonisht ruhen diku dhe mund t'i rikthesh, faqet e djegura përfundojnë në shkrumb që s'kthehet më në fjalë. S'ka rikthim nga hiri. I gjithë ky tmerr u kthye tek unë kur lexova që Marcel Proust kishte udhëzuar shërbëtoren e tij, Céleste Albaret, t'i digjte tridhjetë e dy fletoret e shënimeve që përmbanin skicën origjinale të *Në kërkim të kohës së humbur*. S'mund të mos reshtja së menduari për thesaret që ishin kthyer në tym të vërtetë në kuzhinën e Marcel Proust-it. Asnjëherë s'do ta dimë se cilat ide i kishte braktisur gjatë procesit të shkrimit, si u zhvillua mendimi krijues ndërsa formësohej romani.

Sipas kujtimeve të saj, *Monsieur Proust*, kur Céleste e pyeti shërbëtoren pse dëshironte që ajo t'i digjte fletoret e shënimeve, ai i tha që s'kishte

më nevojë për to. Kjo, megjithatë nuk më bindi. Proust-i ishte njeri me ndjeshmëri të madhe: apartamenti në bulevardin *Haussmann* ishte plot me orenditë e prindërve të vdekur sepse ai s'mund të duronte të hiqte asnjërën prej tyre. Ideja se ka qenë i gatshëm të shkatërroj thelbin e kryeveprës së tij, e cila deri në atë çast ishte thujse arsyeja pse kishte jetuar, dukej krejt e panatyrshme. Nëse s'do të dëshironte që fletoret e shënimeve t'ia shtonin rrëmujën në dhomën e gjumit tashmë kaotike ku



zakonisht shkruante, fare lehtë mund t'ua kishte gjetur vendin në njërën nga studiot boshe, ose t'i hidhte në kosh. Sërish më vinte në mendje e njëjta pyetje: pse *t'i djegësh*?

Sigurisht, shumica e shkrimtarëve i djegin shkrimet e tyre sepse duan të jenë absolutisht të sigurt se askush tjetër s'do ta lexojë kurrë atë që ata shkruan. Djegia bëhet gjithnjë me një sy tek brezat e ardhshëm por gjërat s'kanë dalë gjithmonë ashtu siç kanë shpresuar shkrimtarët.

Vladimir Nabokovi e udhëzoi të shoqen të digjte fragmentet e romanit të papërfunduar, *Origjinali i Laurës*, pas vdekjes, sepse nuk mendonte se libri ishte gati të botohej. Fama e Nabokovit ishte e tillë që ai e dinte se do të kishte interes të madh për çfarëdo vepre që do të linte pas. Ndoshta kishte frikë se libri do ta dëmtonte trashëgiminë e tij letrare, ose motivet e tij ishin thjesht estetike. Cilado qoftë arsyeja, ai dëshironte që romani i papërfunduar të digjej.

Siç rrodhën ngjarjet, Vera Nabokovi nuk ia përmbushi porositë. S'ishte në gjendje t'i digjte 138 kartat treguese. Sipas të birit, Dmitrit, ajo ngurroi për shkak të "moshës, dobësisë dhe dashurisë së pafundme". Për vite me radhë, kartat u mbajtën pa u parë nga askush në kasafortën e një banke zvicerane. Vera i dogji, por as nuk i botoi. Këtë nder të dyshimtë për t'i botuar e pati Dmitri në vitin 2009, i cili mëtoi se kishte luftuar fort me veten (megjithëse ka patur hamendësime se vendimi ishte të paktën pjesërisht i diktuar nga nevojat financiare). Pritja kritike e *Origjinalit të Laurës* ishte jombresëlënëse, për të thënë më të paktën. Vërejtjet ishin si etike ashtu edhe estetike. Shumë menduan se dëshira e autorit duhej të



ishte respektuar. Të tjerë menduan se libri, në atë gjendje, thjesht ishte i tmerrshëm. Martin Amis, nga ata shkrimtarë që nuk para mëdyshet ku fshikullon ndokënd, shkroi në *The Guardian*: “Kur një shkrimtar nis e del nga shinat, ti pret zhurmën e lokomotivës dhe ndonjë xham të thyer, por me Nabokovin, natyrisht, shpërthimi është në shkallën e një aksidenti bërthamor”. Pra, doli që Nabokovi kishte arsye të forta pse kishte dashur që libri t’i digjej.

Ndërsa fati i *Originalit të Laurës* është vetëm një poshtëshënim i çuditshëm në karrierën e shkëlqyer të Nabokovit, vendimi i Nikolai Gogolit për të djegur shkrimet e pabotuara krijoi një lloj trashëgimie tjetër. Në ditët tona, autori i *Frymë të vdekura* dhe *Hunda* është ndoshta aq i njohur për ato që shkatërroi sa për ato që shkroi.

Kur Gogoli u kthye nga Evropa në vitin 1848, surrealizmi i tij i shkëlqyeshëm grotesk i kishte siguruar popullaritet, por ai donte që veprat t’i njiheshin më shumë sesa thjesht komedi absurde. *Frymë të vdekura* synonte të ishte trilogji, homazh për *Komedinë Hyjnore* të Dantes. Pjesa e parë e librit ishte *Ferri* i tij, pjesa e dytë, *Purgatori*. Por Gogoli ishte i pakënaqur dhe i shkurajuar në vëllimin e dytë. Në atë kohë ishte nën ndikimin e një prifti ultra-ortodoks, At Matvei Konstantinovskiy-t, i cili të shkruarit e shihte si “vepër të djallit”. Në vitin 1852, i yshtur nga një larmi sëmundjesh, depresioni, zhgënjimi artistik dhe (falë priftit) pendimi shpirtëror, Gogoli dogji disa dorëshkrime, duke përfshirë vëllimin e dytë të *Frymë të vdekura*.

Ende nuk është plotësisht e qartë nëse ai vërtetë ka patur ndërmend ta djegë romanin. Disa studiues shpjegojnë se më pas ai pohoi të ketë bërë një gabim, më saktësisht, ishte mashtruar nga djalli për ta djegur vëllimin. Nëntë ditë më vonë, vdiq, vdiq nga uria që i diktoi vetes.

Çfarëdo trashëgimie tjetër që mund të lërë pas, një dorëshkrim i djegur mund të jetë dhuratë për shkrimtarët. Ndoshta është e pashmangshme që miti i Gogolit të sillet më shumë rreth librit që shkatërroi, sesa rreth veprës që mbijetoi.

Historia është e jashtëzakonshme: një veprim i pamenduar - asgjësimi i një dorëshkrimi, pendimi i mundshëm i mëvonshëm, i ndjekur nga një vdekje e trishtë, dhe, ndoshta më e rëndësishmja, një vepër gjeniale e mbijetuar për të na shqetësuar për atë që e përpiu zjarri. E gjitha kjo të bën të shtrosh pyetjen: a do të ishte Gogoli kaq shumë

i adhuruar sa sot, nëse nuk do ta kishte djegur dorëshkrimin e tij?

Historia e vendimit të Marcel Proust-it për të djegur fletoret e shënimeve nuk ka fituar të njëjtin status mitik si akti i djegies së dorëshkrimit nga Gogoli, deri diku sepse *Në kërkim të kohës së humbur* mbijetoi, të shtatë vëllimet. Megjithatë, fletoret e shënimeve vazhduan të më mbesin në me mendje. Më në fund kuptova se ka një mënyrë që dëmi i një zjarri të zhbëhet, që fjalët dhe faqet e shkruara mund të rikrijohen nga hiri: përmes letërsisë.


Vetë plotnia e shkatërrimit na lejon ta kthehejmë orën pas, të ruajmë fjalët nga flakët dhe ta imagjinojmë se çfarë u shkatërrua dhe pse. Në romanin tim të ri, *Orët e Parisit*, unë rirrefej historinë e djegies së fletoreve të shënimeve të Proust-it, porse kësaj here shërbyesja e tij (imagjinare) e shpëton njërin nga zjarri. Ajo e fsheh, e mban si një kujtim të çmuar. Pas vdekjes së shkrimtarit, fletorja e shënimeve e ngushëllon ndërsa mban zi për punëdhënësin e saj të dashur.

Sigurisht, kjo rishkrim i ankthshëm i historisë u nxit deri diku nga shqetësimi im për aktin fillestar të shkatërrimit. Shpresoja t’i ndreqja punët, të paktën në universin tim imagjinar. Doja t’i ruaja ato fletore shënimesh. Por edhe në shkrimin letrar, asgjë nuk është asnjëherë aq e thjeshtë.

Para së gjithash, ende nuk mund ta kuptoja pse Proust-i kishte këmbëngulur që Celeste të digjte fletoret e shënimeve. Duhet të ketë qenë diçka në ato faqe që Proust-i donte ta fshihte përgjithmonë dhe thjesht nuk dija se çfarë. Kështu që fillova të hamendësoj, siç e kanë zakon romancierët. Si pasojë, ajo fletore shënimesh e shpëtuar i shkaktoi shërbyesës time shumë më tepër probleme sesa thjeshtë ta kishte djegur. Asnjë nga këto nuk ishte e qëllimshme, me të vërtetë, por pyes veten nëse në nënvetëdiqe e kuptoja që gjithmonë do të kishte një haraç për aktin tim imagjinar të ringjalljes. Sapo harku të dalë nga shigjeta, nuk ka më kthim prapa.

Dhe Alcott-i, Gogoli, Nabokovi dhe Proust-i, e dinin fort mirë, se kjo është çështja.

Përktheu: Granit Zela



Fitues i çmimit Nobel për Letërsinë 1920

knut Hamsun
ZGJIMI I TOKËS



BOTIMET
TOENA